dëmin e shkaktuar nga kryerja e asaj veprimtarie, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

11. Në rast se dëmi në mjedis ka ndodhur, Agjencia Kombëtare e Mjedisit:

a) i kërkon operatorit të sigurojë informacion të mëtejshëm për dëmin e shkaktuar;

b) merr, i kërkon apo i jep udhëzime operatorit për të marrë të gjitha masat e nevojshme për kontrollin, ruajtjen, eliminimin apo për ndonjë lloj tjetër menaxhimi të faktorëve që kanë shkaktuar dëmin në mjedis, me qëllim kufizimin apo parandalimin e dëmeve të mëtejshme në mjedis, efekteve negative në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe vënien në rrezik të burimeve natyrore;

c) i kërkon operatorit të marrë masat e nevojshme rehabilituese, si dhe i siguron atij udhëzimet e duhura për masat rehabilituese që duhet të merren;

ç) merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, me shpenzimet e operatorit, në rast se operatori nuk e ka përmbushur këtë detyrim;

d) merr masat e nevojshme rehabilituese apo cakton një subjekt tjetër fizik apo juridik, për të marrë masat e duhura, në rast se operatori nuk mund të identifikohet, apo nuk i kërkohet të përballojë shpenzimet, siç parashikohet në pikat 2 e 3 të nenit 54 të këtij ligji.

12. Agjencia Kombëtare e Mjedisit specifikon masat rehabilituese për sa i përket dëmit të shkaktuar në mjedis.

13. Në rastin e një dëmi të shkaktuar në mjedis, operatori përcakton dhe propozon masat e nevojshme rehabilituese, siç parashikohet në shkronjën "a" të pikës 4 të këtij neni, dhe ia paraqet ato Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për miratim. Gjatë përcaktimit të masave rehabilituese, operatori merr parasysh që këto masa të jenë të përshtatshme dhe efikase për eliminimin e të gjithë dëmit që i është shkaktuar mjedisit.

14. Në rast se dëmi i shkaktuar në mjedis është i tillë që masat rehabilituese nuk mund të merren njëherazi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton masat parësore dhe me kosto më të ulët që do të ndërmerren. Në përcaktimin e masave parësore, Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr parasysh natyrën, shkallën dhe rëndësinë e secilit prej dëmeve të shkaktuara në mjedis, rrezikun ndaj shëndetit të njeriut, si edhe aftësinë e rehabilitimit natyror të mjedisit.

15. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për identifikimin e operatorit që paraqet kërcënimin e drejtpërdrejtë për një dëm të mundshëm apo që ka shkaktuar dëmin në mjedis, për vlerësimin e rëndësisë së dëmit të shkaktuar, si dhe për përcaktimin e masave rehabilituese.

Neni 51

Shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese

1. Operatori mbulon shpenzimet për masat parandaluese dhe rehabilituese për dëmin që ai ka shkaktuar në mjedis.

2. Pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, operatori nuk bën kompensimin e shpenzimeve për marrjen e masave parandaluese e rehabilituese për dëmin e shkaktuar në mjedis, në rast se ai vërteton që dëmi i shkaktuar apo kërcënimi për shkaktimin e një dëmi në mjedis:

a) është pasojë e një fenomeni natyror të paparashikueshëm dhe të pashmangshëm, i cili nuk mund të parandalohej apo të eliminohej;

b) është shkaktuar nga një palë e tretë dhe/ose ka ndodhur pavarësisht nga marrja e masave të duhura;

c) është pasojë e zbatimit të një vendimi të detyrueshëm, të lëshuar nga një autoritet publik.

3. Operatori nuk është i detyruar të kompensojë shpenzimet për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese, në rast se vërtetohet që dëmi në mjedis nuk është shkaktuar për faj të tij, por është shkaktuar nga:

a) një shkarkim apo veprimtari tjetër e autorizuar apo në përputhje me kushtet e përcaktuara në lejen përkatëse të mjedisit;

b) një shkarkim, veprim, apo një produkt i përdorur a i prodhuar nga veprimtaria, potenciali dëmtues i të cilit në momentin e shkaktimit të dëmit, ishte i panjohur nga shkenca.

Neni 52

Kompensimi i dëmit në mjedis

1. Subjektet fizike apo juridike dhe shoqatat mjedisore në territorin, që preket drejtpërdrejt apo vuan pasojat e dëmit të shkaktuar në mjedis, kanë të drejtë t'i kërkojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit të kërkojë nga operatori:

a) rikthimin e mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme;

b) kompensimin e dëmit të shkaktuar në mjedis, në përputhje me sa parashikohet në këtë ligj, nëse rikthimi i mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme është i pamundur.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlerëson se rehabilitimi dhe kthimi i mjedisit në gjendjen që kishte para se të shkaktohej dëmi është i pamundur, detyron operatorin të paguajë kompensimin për dëmin e shkaktuar në mjedis.

Neni 53

Detyrimi për të vënë paraprakisht në dispozicion fonde për kompensimin e dëmit

1. Operatori, që kryen cilëndo nga veprimtaritë e përmendura në listën e referuar në shkronjën "a" të pikës 3 të nenit 50 të këtij ligji, vë, paraprakisht, në dispozicion fondet e nevojshme për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis.

2. Këshilli i Ministrave miraton metodat dhe procedurat për sigurimin e fondeve të tilla, si garancitë apo siguracionet e nevojshme.

Neni 54

Burime të tjera për mbulimin e shpenzimeve për masat rehabilituese

1. Buxheti i Shtetit siguron burimet për rehabilitimin e dëmit, pasojat e të cilit duhen eliminuar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në shkronjën "a" të pikës 4 të nenit 50 të këtij ligji, kur identifikimi i operatorit është i pamundur.

2. Buxheti i Shtetit siguron fondet financiare për korrigjimin e një dëmi shumë të madh në mjedis, që është shkaktuar nga një veprimtari që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur operatori i referuar në pikat 1 e 2 të këtij neni identifikohet më pas, i kërkon atij rimbursimin e shpenzimeve të bëra për eliminimin e pasojave të dëmit në mjedis brenda një periudhe prej pesë vitesh nga identifikimi i këtij të fundit.

KREU IX

INSTRUMENTET DHE MJETET E POLITIKËS SË MBROJTJES SË MJEDISIT

Neni 55

Ekoetiketa

1. Ministria i jep ekoetiketën, si një shenjë dalluese dhe njohjeje, personave fizikë dhe juridikë, që prodhojnë apo shpërndajnë produkte, të cilat, në krahasim me produktet apo shërbimet e barasvlershme, gjatë ciklit të jetës së tyre kanë ndikim më pak negativ dhe sigurojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje të mjedisit, si dhe përdorim me efektshmëri më të lartë të përbërësve të tij.

Produkte të tilla, si ato ushqimore, pijet, produktet farmaceutike dhe pajisjet mjekësore profesionale apo shërbime të lidhura me to nuk janë objekt i këtij neni.

2. Vlerësimi i efekteve më pak negative, të referuara në pikën 1 të këtij neni, ka të bëjë me përdorimin racional të burimeve natyrore dhe të energjisë, reduktimin e shkarkimeve në mjedis, përdorimin e mbetjeve që kanë vlerë apo me metoda të tjera, që bëjnë të mundur shfrytëzimin e mbetjeve para asgjësimit të tyre në fushën përkatëse (landfill) dhe marrjen e masave të tjera për mbrojtjen e mjedisit.

3. Prodhuesi, importuesi, shpërndarësi i një prodhimi apo shërbimi mund të kërkojë të pajiset me ekoetiketën, e cila duhet të përmbajë bashkëlidhur të gjitha dokumentet dhe provat që produkti në fjalë i përmbush kërkesat e përcaktuara.

4. Ministria mund ta heqë ekoetiketën e dhënë kur personi i referuar në pikën 3 të këtij neni nuk vepron në pajtim me kërkesat, në bazë të të cilave është dhënë etiketa, ose nuk i përmbush më kërkesat e përcaktuara për pajisjen me etiketë.

5. Ministria promovon përdorimin e produkteve dhe shërbimeve, që kanë ekoetiketën, përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit të konsumatorëve, prodhuesve, tregtuesve dhe publikut.

6. Këshilli i Ministrave miraton procedurën dhe kërkesat për pajisjen me ekoetiketën, mënyrën e dhënies, përdorimit dhe vlefshmërisë së saj, përbërjen dhe funksionimin e komisionit për lëshimin e ekoetiketave, pjesëmarrjen e individëve, shoqatave dhe të autoriteteve publike në procedurën e dhënies së ekoetiketës, të referuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 56
Skema e ekomenaxhimit dhe auditimit

1. Ministria nxit përdorimin e skemës së ekomenaxhimit dhe auditimit dhe pjesëmarrjen vullnetare të organizatave, me qëllim vlerësimin dhe përmirësimin e performancës mjedisore të tyre dhe të palëve të tjera të interesuara.

2. Këshilli i Ministrave miraton procedurat dhe kërkesat për dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit.

Neni 57
Marrëveshjet vullnetare

1. Organizata dhe grupe, që përfaqësojnë interesa të caktuar, grupe operatorësh ose operatorë individualë, mund të lidhin marrëveshje vullnetare me autoritetet përkatëse, në mënyrë që të realizojnë një nivel mbrojtjeje më të lartë sesa ai i përcaktuar në legjislacionin e posaçëm për një përbërës mjedisor.

2. Procedurat dhe kërkesat e tjera të hollësishme për zbatimin e këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.

3. Secila prej këtyre marrëveshjeve vullnetare është e detyrueshme nga çasti i nënshkrimit dhe mospërmbushja e kushteve të caktuara në të konsiderohet si një shkelje e kontratës.

Neni 58
Edukimi dhe trajnimi për mbrojtjen e mjedisit

1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe për formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë, nxitin, mbështetin dhe organizojnë edukimin dhe trajnimin për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përmes sistemit arsimor, kërkimit shkencor, formave të të mësuarit, të të formuarit dhe të trajnimit gjatë gjithë jetës.

2. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe për formimin profesional, në bashkëpunim me ministrinë, formulojnë udhëzimet e duhura për një

program mësimor dhe edukativ, në përputhje me përparësitë dhe objektivat e programeve strategjike kombëtare e ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë.

KREU X
ORGANET SHTETËRORE PËR MJEDISIN

SEKSIONI 1
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Neni 59
Organizimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj.

4. Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.

5. Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit.

Neni 60
Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione:

a) hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

b) përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit;

c) kryerjen e shërbimeve të matjes së shkarkimeve në mjedis me kërkesë të ministrisë;

ç) këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;

d) krijimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor;

dh) krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;

e) sigurimin e informacionit mjedisor për publikun, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ë) sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

f) sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

g) menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet.

2. Kjo agjenci kryen edhe funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm.

Neni 61
Nëpunësit dhe punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit

1. Për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit zbatohen procedurat e legjislacionit për nëpunësin civil, të parashikuara për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet ndryshe në

këtë ligj. Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është "eprori i drejtpërdrejtë", në përputhje me këto dispozita. Titullari i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit emërohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Marrëdhëniet e punës të punonjësve të tjerë të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, i nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

SEKSIONI 2
INSPEKTIMI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Neni 62
Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit

(Ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1, shtuar pika 3 me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

1. Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit, përveç sa parashikohet në pikën 2 të këtij neni, kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, në vijim "Inspektorati". Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe ka këto funksione:

a) siguron kontrollin shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në këtë ligj dhe në legjislacionin e posaçëm në fuqi;

b) siguron përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit për lejet e mjedisit;

c) përgatit programet vjetore të inspektimit dhe për sigurimin e zbatimit të tyre;

ç) siguron informimin për publikun për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

d) siguron informimin për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet e mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

dh) siguron zbatimin e parimit të përgjegjësisë mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

e) kryen kontrollin për zbatimin e detyrave, të shoqëruara me hetimin e zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur. Inspektori i mjedisit mund të kryejë edhe detyra të tjera, të përcaktuara në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit;

ë) çdo funksion tjetër të përcaktuar në ligje të tjera të posaçme, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

2. Inspektimi për zbatimin e këtij ligji, për sa i përket tregtimit të produkteve, lëndëve të para, substancave kimike dhe paketimit të kimikateve, si dhe etiketimit të produkteve dhe informacionit që përmban paketimi, lidhur me ndikimet në mjedis, kryhet nga strukturat inspektuese përkatëse, sipas legjislacionit të posaçëm.

3. Funksionet e inspektimit ushtrohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit për inspektimin.

Neni 63
Fusha e inspektimit

Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit përfshin:

a) kontrollin dhe nxitjen e përputhjes së veprimtarive me kërkesat e legjislacionit përkatës;

b) monitorimin e ndikimit të veprimtarive mbi mjedisin për të përcaktuar nëse kërkohen veprime të mëtejshme, duke përfshirë shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit, për të siguruar përputhjen me legjislacionin përkatës;

c) kontrollin e përmbushjes të standardeve të cilësisë së mjedisit;

ç) verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë;
d) kontrollin dhe promovimin e përputhjes me kërkesat e lejes përkatëse të mjedisit;
dh) verifikimin dhe vlerësimin e monitorimit të përputhjes së bërë nga operatori i veprimtarisë;
e) vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë;
ë) kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve përkatëse, duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e tyre;
f) kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë;
g) kontrollin e dokumenteve të mbajtura nga operatori i veprimtarisë;
gj) kontrollin dhe nxitjen e përputhshmërisë me marrëveshjet vullnetare.

Neni 64
Detyrimi për të siguruar përputhshmërinë

1. Inspektorati ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që, në bazë të këtij ligji, mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit.
2. Inspektorati ka për detyrë të ndërmarrë çdo veprim që, në bazë të këtij ligji, mund të jetë i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në dispozitat e legjislacionit për ndërtimet, për veprimtaritë e planifikuara, për të cilat nevojitet kryerja e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Neni 65
Njoftimet për përputhshmërinë

1. Inspektorati, në rast se vlerëson se operatori ka shkelur, po shkel apo ka gjasa të shkelë kushtet e lejes përkatëse të mjedisit, i dërgon atij njoftimin për përputhshmërinë, një kopje e të cilit i dërgohet autoritetit publik, që ka dhënë lejen për ushtrimin e veprimtarisë.
2. Njoftimi për përputhshmërinë bëhet me shkrim dhe:
a) përshkruan çështjet që përbëjnë shkelje apo ato që tregojnë se ka gjasa që të ndodhë shkelja;
b) përshkruan hapat që merren nga operatori për të korrigjuar shkeljen apo për të korrigjuar çështjet që tregojnë se ka gjasa që të ndodhë shkelja;
c) përcakton periudhën kohore kur merren këta hapa.
3. Njoftimi për përputhshmërinë mund të përfshijë hapat që merren për të përmbushur kushtet e lejes përkatëse të mjedisit gjatë ndërtimit dhe ushtrimit të veprimtarisë, si dhe hapat për korrigjimin e efekteve të ndotjes së shkaktuar nga shkelja.

Neni 66
Njoftimet për pezullimin

(Shtuar pika 5 me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

1. Inspektorati, në rast se është i mendimit që ndërtimi apo kryerja e një veprimtarie ose ndërtimi, apo kryerja e saj në një mënyrë të caktuar përbën rrezik të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit, ai i dërgon njoftimin për pezullimin e asaj veprimtarie pronarit të sendit apo operatorit të veprimtarisë, sipas rastit. Një kopje e njoftimit për pezullim i dërgohet autoritetit publik, që ka dhënë lejen për ushtrimin e veprimtarisë.
2. Njoftimi për pezullimin bëhet me shkrim dhe në të:
a) përcaktohet rreziku i mundshëm që ka lidhje me ndërtimin apo kryerjen e veprimtarisë;
b) përcaktohen hapat që merren për ta shmangur atë rrezik;
c) përcaktohet periudha kohore kur merren këta hapa;
ç) deklarohet që leja përkatëse e mjedisit apo pjesë të veçanta të saj nuk janë më të vlefshme, derisa të hiqet ky njoftim.

3. Leja përkatëse e mjedisit nuk është më, plotësisht apo pjesërisht, e vlefshme, siç është përcaktuar në njoftimin për pezullimin, në çastin që pronari i sendit apo operatori e ka marrë këtë njoftim.

4. Inspektorati mund ta revokojë njoftimin për pezullimin në çdo kohë në rast se ai vlerëson që janë marrë hapat e kërkuar nga ky njoftim për shmangien e rrezikut të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit.

5. Masa administrative e njoftimit për pezullimin e veprimtarisë, sipas këtij neni, është masë urgjente dhe mund të jepet krahas masave të tjera të nevojshme, në përputhje me ligjin për inspektimin.

SEKSIONI 3
DISPOZITA TË TJERA INSTITUCIONALE

Neni 67
Fondi i mjedisit

1. Për të mbështetur dhe për të nxitur veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit krijohet Fondi i Mjedisit.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për burimin e të ardhurave, mënyrën e funksionimit dhe të përdorimit të Fondit të Mjedisit.

Neni 68
Licencimi i veprimtarive me ndikim në mjedis

Veprimtaritë me ndikim në mjedis, të përcaktuara në këtë ligj, licencohen sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" dhe përfshihen në fushën III të shtojcës së tij.

KREU XI
KUNDËRVAJTJET

Neni 69
Kundërvajtjet
(Ndryshuar pika 2 dhe 6 me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) mosdhënia e informacionit për shkarkimin dhe transferimin e ndotësve nga operatori, sipas përcaktimit të nenit 32 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

b) mospërmbushja e kërkesave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve dhe të pajisjeve që përmbajnë këto substanca, sipas përcaktimit të nenit 35 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

c) mospërmbushja e kërkesave për lëshimin e qëllimshëm në mjedis të Organizmave të Modifikuar Gjenetikisht, për qëllime të tjera, përveç hedhjes së tyre në treg si produkte që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, sipas përcaktimit të nenit 36 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

ç) mospërmbushja e kërkesave për ndalimin e prodhimit, të importit, hedhjes në treg dhe të përdorimit, për reduktimin e shkarkimeve, minimizimin dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm, sipas përcaktimit të nenit 37 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

d) mospërmbushja e kërkesave për shkarkimin e erërave të pakëndshme nga veprimtaritë e reja dhe ekzistuese, sipas përcaktimit të nenit 39 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

dh) mosplotësimi nga personi i autorizuar, që kryen monitorimin e mjedisit, sa më shumë të jetë e mundur, i kërkesave për minimizimin e ndërhyrjes mbi përdorimin e tokës dhe mosplotësimi, pas kryerjes së veprimtarisë, sa më shumë të jetë e mundur, i kërkesave për rikthimin e tokës në gjendjen e saj të mëparshme, sipas përcaktimit të nenit 43 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit;

e) mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për mundësinë e një kërcënimi të drejtpërdrejtë për një dëm të tillë nga operatori, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 50 të këtij ligji, si dhe mosmarrja e masave të nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit në mjedis, pavarësisht nga detyrimi i tij për marrjen e masave parandaluese të dëmit në mjedis, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 50 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

ë) mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori se me gjithë masat e marra në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 6 të nenit 50 të këtij ligji, kërcënimi i drejtpërdrejtë i dëmit në mjedis nuk është shmangur, sipas përcaktimit të bërë në pikën 7 të nenit 50 të këtij ligji, pavarësisht nga detyrimi i tij për të siguruar paraprakisht fondet për kompensimin e një dëmi të mundshëm ndaj mjedisit apo për eliminimin e një kërcënimi të pashmangshëm për dëme në mjedis, sipas përcaktimit të nenit 53 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

f) mospërmbushja e kërkesave të pikës 8 të nenit 50 të këtij ligji, nga operatori, pavarësisht nga detyrimi i tij për të rikthyer mjedisin në gjendjen e mëparshme, rehabilitimin e mjedisit, kompensimin e dëmit të shkaktuar apo për të marrë masa të tjera të përcaktuara në këtë ligj, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

g) përdorimi i ekoetiketës nga zotëruesi i saj edhe pas heqjes së saj nga ministria, sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 55 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

gj) mosplotësimi nga operatori i kërkesave të përcaktuara në njoftimin e përputhshmërisë, brenda afatit të përcaktuar në të, sipas përcaktimit të nenit 65 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në korrigjimin e mospërputhjes;

h) mosplotësimi nga pronari i sendit apo operatori i veprimtarisë i kërkesave të përcaktuara në njoftimin e pezullimit, brenda afatit të përcaktuar në të, sipas përcaktimit të nenit 66 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të gjobës për çdo ditë vonesë, deri në plotësimin e detyrimit.

2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 69 të këtij ligji, e ka inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit. Krahas dënimit kryesor me gjobë, inspektori ka të drejtë të vendosë edhe dënimin plotësues të sekuestrimit të pajisjes, me të cilën, sipas tij, është kryer kundërvajtja e parashikuar në këtë ligj.

3. Pavarësisht nga dënimi i parashikuar në shkronjat "k" dhe "l" të pikës 1 të këtij neni, ministri, me propozimin e inspektoratit, mund të pezullojë apo të revokojë lejen përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj dhe për këtë njofton Qendrën Kombëtare të Licencimit.

4. Në rastin e kundërvajtjeve serioze në këtë ligj, apo kur personi nuk ka paguar gjobën e vendosur sipas këtij ligji, inspektorati ka të drejtë të vërë nën sekuestrim pronën, me të cilën është kryer kundërvajtja.

5. Inspektorati mund të ndërmarrë sanksionet e parashikuara në këtë nen në çdo kohë, por jo më vonë se dy vite kalendarike nga data e nxjerrjes së vendimit për kundërvajtjen administrative, sikurse parashikohet dhe në nenin 46 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

6. Inspektori shqyrton, merr vendimin përfundimtar dhe bën dokumentimin e tij në përputhje me ligjin për inspektimin.

7. Gjoba paguhet brenda periudhës së përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

8. Ministri, me propozimin e inspektoratit, në rastet kur gjoba nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, pezullon lejen përkatëse mjedisore deri në pagesën e gjobës.

9. Subjekti, ndaj të cilit merret masa e pezullimit apo revokimit të lejes së mjedisit, ka të drejtën e ankimit tek titullari i strukturës përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me ligjin nr.10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

11. Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e shmang subjektin përkatës nga detyrime të tjera të përcaktuara në këtë ligj, si dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU XII
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 70
Propozimi i akteve nënligjore

1. Ministri propozon aktet nënligjore, që miratohen nga Këshilli i Ministrave në zbatim të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave dhe/apo ministri miratojnë aktet nënligjore, sipas përcaktimit dhe në zbatim të këtij ligji, brenda një periudhe 2-vjeçare nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 71
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 21 pika 4, 26 pika 2, 27 pika 4, 31 pika 5, 32 pika 4, 35, 36 pika 3, 37 pika 2, 39 pika 2, 41 pika 2, 42 pika 2, 45 pika 3, 47 pika 2, 49, 50 pika 3, 53 pika 2, 55 pika 6, 56 pika 2, 57 pika 2, 59 pika 4, 61 pika 1 dhe 67 pika 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 50 pika 4 të këtij ligji.

Neni 72
Vazhdimi i efekteve juridike për aktet nënligjore

1. Vendimi nr.860, datë 20.12.2006, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë, të qëndrueshëm", miratuar në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 37 të këtij ligji.

2. Vendimi nr.847, datë 29.11.2007, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të mjedisit", miratuar në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 21 të këtij ligji.

3. Vendimi nr. 543, datë 23.6.2005, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese", miratuar në zbatim të nenit 17 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 35 të këtij ligji.

4. Vendimi nr.1189, datë 18.11.2009, i Këshillit të Ministrave "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit", miratuar në zbatim të nenit 53 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 41 të këtij ligji.

Neni 73

Shfuqizime

1. Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji, me përjashtim sa parashikohet në pikat 2 deri në 7 të këtij neni.

2. Pa rënë ndesh me nenin 24 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon Vlerësimit Strategjik Mjedisor deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

3. Pa rënë ndesh me nenin 25 të këtij ligji, dispozitat e kreut IV dhe neni 35 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, vazhdojnë të kenë efekt për sa i takon vlerësimit të ndikimit në mjedis deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

4. Pa rënë ndesh me nenin 29 të këtij ligji, nenet 34, 36-46 dhe 51/1 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për lejen, autorizimin dhe pëlqimin mjedisor, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

5. Pa rënë ndesh me nenin 30 të këtij ligji, neni 49 i ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për parandalimin e aksidenteve industriale, vazhdon të ketë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tij me ligj të posaçëm.

6. Pa rënë ndesh me nenin 33 të këtij ligji, nenet 20-24 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për menaxhimin e mbetjeve, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

7. Pa rënë ndesh me nenin 34 të këtij ligji, nenet 20 dhe 23 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, për importimin dhe transitin e lëndëve të rrezikshme, vazhdojnë të kenë efekt deri në çastin e shfuqizimit të tyre me ligj të posaçëm.

Neni 74

Dispozita kalimtare

Funksionet e dhëna nga ky ligj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe, në mënyrë të veçantë, ato të përcaktuara në nenin 60 të tij të kryhen nga ministria, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, për një periudhë jo më të gjatë se tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(Shtuar me ligjin nr.31/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 75

Ky ligj hyn në fuqi 18 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7033, datë 29.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 9385, datë 4.5.2005

PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR[28]

(*ndryshuar me ligjet: nr.9533, datë 15.5.2006, nr. 9791, datë 23.7.2007 (botuar në fletoren zyrtare nr. 103), nr.9989, datë 15.9.2008 (botuar në fletoren zyrtare nr. 150) nr.10 137, datë 11.5.2009 (botuar në fletoren zyrtare nr. 86), nr.15/2012, datë 16.2.2012 (botuar në fletoren zyrtare nr. 18), nr. 36/2013, datë 14.2.2013 (botuar në fletoren zyrtare nr. 30) dhe nr. 48/2016, datë 5.5.2016, (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84*)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti
(shtuar pika 3, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të njëjta për marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, organeve të pushtetit vendor, organizatave jofitimprurëse, pronarëve privatë dhe të biznesit, për ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, të tokës pyjore dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre.

2. Ky ligj rregullon edhe veprimtaritë mbrojtëse, shoqërore, ekoturistike dhe ekonomike që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar dhe në burimet e tjera pyjore e jopyjore, në bazë të parimeve të mbarështimit të qëndrueshëm e shumëfunksional, të pasqyruara në strategjinë dhe politikat e zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, si dhe skemën e organizimit e të funksionimit të administratës së Shërbimit Pyjor Shqiptar, marrëdhëniet juridike, përgjegjësitë dhe detyrat e tij, për krijimin e një shërbimi pyjor të qëndrueshëm dhe profesional.

3. Nuk janë objekt i këtij ligji zonat e mbrojtura, fauna e egër, si dhe bimët mjekësore eterovajore e tanifere natyrore, të cilat rregullohen sipas legjislacionit të perkatës në fuqi.

---

[28] *Ligji nr.9533, datë 15.5.2006 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, datë 8 qershor 2006.*
Ligji nr. 9791, datë 23.7.2007 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 103, datë 6 gusht 2007.
Ligji nr.9989, datë 15.9.2008 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 150, datë 3 tetor 2008.
Ligji nr.10 137, datë 11.5.2009 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 12 qershor 2009.
Ligji nr.15/2012, datë 16.2.2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 14 mars 2012.
Ligji nr. 36/2013, datë 14.2.2013 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 30, datë 12 mars 2012.
Ligj nr. 48/2016, datë 5.5.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84, datë 19 maj 2016.

Neni 2

Përkufizime dhe fushat e veprimit

(shtuar një paragraf në pikën 21 dhe shtuar pikat 31, 32 dhe 33, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 10, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Burime pyjore" është tërësia e elementeve natyrore të një sipërfaqeje pylli a toke pyjore, me vlerë të konsiderueshme, të përdorshme për nevojat e njeriut. Në ekonominë pyjore si burime natyrore përfshihen edhe toka, uji, bimësia jopyjore, e shumëllojshme, ato të natyrës jo të gjallë dhe gjallesat e egra.

2. "Dëmtim i pyjeve dhe i mjedisit pyjor" është prishja e karakteristikave fiziko-kimike e strukturore të ekosistemit pyjor, ulja e prodhimtarisë biologjike dhe e shumëllojshmërisë së ekosistemeve përbërëse të fondit pyjor kombëtar.

3. "Drurë apo grupe drurësh pyjorë" janë drurët pyjorë të veçantë, kudo që ndodhen, një sipërfaqe me drurë pyjorë prej 0,05 hektarësh, brezat mbrojtës, parqet urbane, grupet e drurëve të mbjellë në parcela të vogla dhe që përdoren për kullotë.

4. "Ekonomi pyjore" është sipërfaqja pyjore e ndarë në ngastra e nënngastra, si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit të pyllit dhe që plotëson parimin e vazhdimësisë së prodhimit pyjor.

5. "Ekosistem" është një kompleks dinamik komunitetesh: bimë, kafshë, mikrobe dhe mjedisi jo i gjallë, që ndërveprojnë si njësi funksionale.

6. "Fidanishte pyjore" është një sipërfaqe toke, e destinuar për të rritur e prodhuar, për një periudhë të caktuar kohe, fidanë të llojeve e madhësive të ndryshme, me prejardhje nga farërat, kalemat, copat, rrënjët, shpatullat e zhardhokët.

7. "Fond pyjor" janë të gjitha sipërfaqet pyjore e jopyjore, burimet pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese, infrastruktura përkatëse, përfshirë edhe sipërfaqet e zhveshura, të cilat krijojnë një mjedis harmonik me pyjet e tokën pyjore (çeltirat, shkëmbinjtë, dunat dhe ranishtet), brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve dhe shkurret.

8. "Grumbull pyjor" është një sipërfaqe pyjore, homogjene nga pikëpamja e përbërjes së llojeve, moshës, klasës së prodhimit, dendësisë, kushteve mjedisore dhe mënyrës së trajtimit silvikulturor.

9."Infrastrukturë pyjore" janë zyrat, ndërtesat, magazinat, depot, rrjeti rrugor pyjor, teleferikët, makinat, motorët, radiot e antenat e radiokomunikimit, pritat, pendat, lerat, koritat, çezmat, rrethimet e gardhimet, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese, ato të mbarështimit pyjor, si dhe lehtësitë e tjera të ngritura në fondin pyjor shtetëror për informimin dhe pritjen e vizitorëve.

10. "Inspektor i Policisë Pyjore" është punonjësi me arsimin përkatës pyjor, me uniformë, i armatosur, i pajisur me kartë identifikimi, që ka atributet e njohura me këtë ligj, i inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet, i cili ka për detyrë zbatimin e ligjit, administrimin, mbrojtjen, parandalimin e dëmtimeve, zbulimin e veprimtarive kriminale dhe mbikëqyrjen e fondit pyjor kombëtar.

11. "Kadastra e pyjeve" është një dokument zyrtar (regjistër), ku evidentohen, pasqyrohen, mbahen e përditësohen të dhënat fillestare për çdo njësi të ekonomisë pyjore apo për pellgjet ujëmbledhëse, të dhënat për ndryshimet periodike në vëllime, sipërfaqet dhe hartat përkatëse.

12. "Mbarështim pyjor" është planifikimi afatmesëm e afatgjatë, në nivel ekonomie pyjore apo të pellgut ujëmbledhës, i cili siguron përmbushjen e kërkesave për ruajtjen e pyllit, duke mbajtur parasysh aspektet ekologjike, ekonomike e shoqërore. Këtu përfshihen mbledhja e të dhënave, përcaktimi i objektivave, i masave për çdo njësi mbarështimi apo për të gjithë ekonominë dhe kontrollin e vazhdueshëm të rezultateve.

13. "Mbrojtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

14. "Ndotja e pyjeve dhe e mjedisit pyjor" është ndryshimi i cilësisë së tyre, si rrjedhojë e krijimit dhe e futjes së faktorëve fizikë, kimikë apo biologjikë, të burimeve natyrore a njerëzore, nga brenda ose jashtë vendit.

15. "Nënngastër" është një njësi sipërfaqeje me madhësi minimale 0,5 ha, që shërben për vlerësimin e grumbujve pyjorë, planifikimin dhe kontrollin e trajtimeve të njëjta silvikulturore.

16. "Ngastër" është ndarja e sipërfaqes së ekonomisë pyjore në parcela, të cilat shërbejnë si njësi bazë për drejtimin, organizimin, planifikimin dhe kontrollin e mbarështimit të pyllit.

17. "Plan mbarështimi" është një dokument bazë për mbarështimin e pyjeve, i hartuar sipas njësive të ekonomisë pyjore, me punime terreni e zyre, për njohjen dhe marrjen e të dhënave për tokën, klimën, faunën, biodiversitetin, grumbullin pyjor etj., si dhe masat që parashikohen për administrimin dhe qeverisjen e qëndrueshme të fondit pyjor, organizimin e prodhimit dhe planifikimin e punimeve të ndërthurura, të nevojshme silvikulturore.

18. "Prerje kulturore" është tërësia e punimeve të seleksionimit dhe të rrallimit, pastrimit, çlirimit etj., që zbatohen periodikisht në një grumbull pyjor, nga çasti i krijimit të gjendjes së masivit e deri në moshën e shfrytëzimit, për përmirësimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së prodhimit.

19. "Pronë pyjore" është një sipërfaqe e fondit pyjor, me madhësi të ndryshme, bashkë me infrastrukturën përkatëse, e cila është pronë publike, që zotërohet nga pushteti qendror apo vendor, ose pronë private.

20. "Pyje mbrojtëse" janë pyjet e përcaktuara kryesisht për qëllime mbrojtëse të vetë pyllit, të tokës pyjore dhe të tokave, që shtrihen përreth zonave urbane, pellgjeve ujëmbledhëse, për të luftuar a parandaluar dukuritë e gërryerjes, të ndikimit të erërave, çrregullimeve në rrjedhjet ose burimet ujore dhe sigurimin e funksioneve ekologjike.

21. "Pyll" është sipërfaqja e tokës me një grup të dendur drurësh pyjorë, në formë të qëndrueshme ose me bimësi tjetër të rrallë pyjore, me sipërfaqe më të madhe se një dynym e me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 për qind, që prodhon masë drusore, ushtron ndikim në mjedisin rrethues dhe që siguron funksionet e pyllit.

Për zbatimin e Protokollit të Kiotos pyll vlerësohet edhe sipërfaqja e tokës me një grup të dendur drurësh pyjorë, me sipërfaqe më të madhe se 0,1 ha, me shkallë mbulimi jo më të vogël se 30 për qind dhe me potencial për të arritur lartësi më të madhe se 3 metra, kur pylli ka arritur maturinë në kushte in-situ.

22. "Qeverisje e pyjeve" është tërësia e ligjësisë dhe biologjia e bashkësisë së jetës së pyllit e të tokës pyjore, përcaktimi i qartë i politikave dhe i masave, me të cilat do të ndërhyhet në strukturën funksionale të tyre, për të siguruar rritjen e frytshmërisë teknikoekonomike.

23. "Rrugë pyjore" janë rrugët me parametra të ndryshme nga ato të rrugëve vendore dhe kombëtare, për qarkullimin e automjeteve dhe të mjeteve të tjera, që shërbejnë për transportin e lëndës drusore, të prodhimeve të tjera me origjinë jodrusore, për kryerjen e punimeve të ndryshme dhe lidhjen e sipërfaqes pyjore me rrjetin e rrugëve vendore e kombëtare.

24. "Shfrytëzim i pyjeve" janë ndërhyrja dhe trajtimet silvikulturore në jetën e pyllit, vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera, përpunimi dhe transporti i tyre në moshën e shfrytëzueshmërisë dhe kur është siguruar ripërtëritja natyrore.

25. "Shitja e drurit në këmbë" është operacioni i vlerësimit dhe i shitjes së drurëve të paprerë apo të parrëzuar.

26. "Shkurre" është bimësia drusore, me kërcenj të degëzuar nga baza dhe jo shumë të lartë, që dallohet nga bimësia barishtore prej strukturës drusore, ndërsa nga pylli prej trungut të shkurtër dhe mungesës së trungut kryesor.

27. "Silvikulturë" është shkenca që merret me studimin e ligjësive të jetës dhe të zhvillimit të ekosistemeve pyjore, me përcaktimin e metodave dhe të teknikave të trajtimit të tyre, që synojnë rritjen dhe vazhdimësinë e prodhimit pyjor.

28. "Toka pyjore" janë sipërfaqe toke me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30 për qind, sipërfaqet e zhveshura, çeltirat, vendet shkëmbore, tokat e

gërryera e joprodhuese, ranishtet, rrugët pyjore, të pakadastruara në fondet e tjera të tokës bujqësore dhe të lidhura ekologjikisht e në mënyrë funksionale me fondin pyjor kombëtar që, të gjitha së bashku, sigurojnë funksionet e pyllit.

29. "Trajtim i pyjeve" janë operacionet silvikulturore, të cilat kanë si qëllim kryesor zhvillimin, vjeljen e prodhimeve pyjore dhe sigurimin e ripërtëritjes natyrore të një pylli, brenda mundësive të një forme të caktuar qeverisjeje.

30. "Veprimtari pyjore" janë të gjitha veprimtaritë mbrojtëse, menaxhuese e qeverisëse, ekonomike e tregtare, të vjeljes së materialit drusor dhe të prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore, veprimtaritë çlodhëse, turistike, sportive e argëtuese, si dhe ato kërkimore e shkencore, që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar.

31. "Ministria" është ministria përgjegjëse për pyjet.

32. "Ministër" është ministri përgjegjës për pyjet.

33. "Pyll komunal" është pylli në pronësi apo në përdorim të organeve të qeverisjes vendore.

KREU II
POLITIKAT, PROGRAMET E ZHVILLIMIT DHE PLANET E MBARËSHTIMIT PYJOR

Neni 3
Këshilli i politikave pyjore

1. Politikat sektorale synojnë zbatimin e kërkesave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për pyjet, kullotat dhe burimet e tjera, pyjore e natyrore, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Për hartimin e politikave dhe të strategjive të zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe të kullotave në Republikën e Shqipërisë ngrihet Këshilli i Politikave të Zhvillimit të Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, i cili funksionon si organ ndërministror.

Përbërja, funksionet, përgjegjësitë, të drejtat dhe organizimi i brendshëm i këtij këshilli caktohen me urdhër të Kryeministrit.

Neni 4
Programet e zhvillimit
(ndryshuar pika 4, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Qeverisja e fondit pyjor kombëtar mbështetet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm e shumëfunksional të pyjeve e kullotave, të përfshira në strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, në programin kombëtar dhe në planet afatgjata të veprimit.

2. Programi i zhvillimit të sektorit të pyjeve dhe kullotave përcaktohet nga politika e mbarështimit pyjor, për ruajtjen, zhvillimin e fondit pyjor kombëtar, për sigurimin e kushteve për përdorimin dhe shfrytëzimin e tij edhe për qëllime publike.

3. Programi i zhvillimit të sektorit të pyjeve përshtatet dhe plotësohet, në përputhje me ndryshimet e gjendjes shoqërore e ekonomike të vendit dhe me ndryshimin e kushteve të mbarështimit pyjor.

4. Ministria, në bashkëpunim me bashkitë, harton dhe përpunon programin e zhvillimit të sektorit të pyjeve, i cili miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 5

Planet e mbarështimit

(ndryshuar pika 4 dhe shtuar pikat 5 e 6, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 3, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

1. Qeverisja teknike e sektorit të pyjeve dhe të kullotave bëhet sipas planeve të mbarështimit.

2. Planet e mbarështimit pyjor duhet të sigurojnë masat për:

a) zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor kombëtar, ruajtjen dhe krijimin e kushteve natyrore për gjallesat pyjore dhe komunitetet e tyre;

b) mbrojtjen, trajtimin dhe kryerjen e punimeve silvikulturore e të punimeve të tjera, të cilat kanë për qëllim sigurimin e funksioneve ekologjike dhe shoqërore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, vjeljen e prodhimeve pyjore dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, duke siguruar vazhdimësinë e prodhimeve pyjore, të burimeve të tjera dhe të gjeneratës së re të masivit pyjor;

c) mbarështimin e pyllit dhe të tokës pyjore, për të ruajtur funksionet e tyre, shkallën e ruajtjes së mjedisit pyjor dhe të ripërtëritjes natyrore;

ç) përdorimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore e natyrore të ngastrave e ekonomive pyjore, në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm të gjallesave pyjore dhe të komuniteteve të tyre.

3. Për të siguruar asistencë të kualifikuar për hartimin e planeve të mbarështimit, të ekspertizave, të projekteve operacionale dhe zbatimin e tyre në fondin pyjor, ministri certifikon ekspertë, të certifikuar në këtë fushë. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, ato i nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat. Këshilli i Ministrave miraton kriteret, rregullat dhe procedurat për certifikimin e ekspertëve dhe licencimin në fushën e fondit pyjor.

4. Plani i mbarështimit të pyjeve shtetërore shqyrtohet nga komisioni teknik pranë Drejtorisë së Politikave Pyjore, i ngritur me urdhër të ministrit. Plani miratohet nga ministri.

5. Planet e mbarështimit të pyjeve komunale dhe private hartohen nga subjekte të licencuara dhe miratohen, sipas rastit, nga këshilli i komunës/bashkisë, në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor.

6. Mënyra e hartimit të planeve të mbarështimit të pyjeve, e cila zbatohet për të gjitha format e pronësisë së pyllit, caktohet me udhëzim të ministrit.

KREU III

SHËRBIMI PYJOR

Neni 6

Funksionimi i shërbimit pyjor

(shtuar pika 3, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Shërbimi pyjor funksionon në mbështetje të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, të nxjerra nga organet përkatëse, të ngarkuara për zbatimin e ligjit.

2. Shërbimi pyjor ka këto funksione:

a) menaxhuese;

b) kontrolluese.

3. Funksioni kontrollues ushtrohet nga Policia Pyjore, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Neni 7

Organizimi i shërbimit pyjor

(ndryshuar pikat 2 dhe 3, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 1, 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar pikat 2, 3, dhe shtuar pika 3/1me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Shërbimi pyjor organizohet e vepron sipas parimeve të profesionalizmit, pavarësisë, transparencës, shërbimeve ndaj publikut, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

2. Shërbimi pyjor organizohet si më poshtë:

a) ministria përgjegjëse për pyjet, si organ qendror politikëbërës;

b) strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki;

c) Policia Pyjore, pjesë e inspektoratit shtetëror përgjegjës për pyjet.

3. Strukturat dhe organikat e shërbimit pyjor në ministrinë përgjegjëse për pyjet dhe Policisë Pyjore miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

3/1. Bashkia ngre strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorialë administrativë, me personel inxhiniero-teknik me arsim pyjor. Raporti midis një nëpunësi të bashkisë me sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullosor që ai mbulon është jo më pak se një nëpunës për:

a) 750–1 000 ha, për pyjet e larta;

b) 1 500–2 500 ha, për pyjet e ulëta dhe shkurret;

c) 4 000–6 000 ha, për kullota dhe livadhe.

4. Organizimi dhe funksionimi i inspektoratit shtetëror të ministrisë që mbulon fushën e mjedisit, pyjeve dhe administrimit të ujërave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 8

Bordi Këshillimor i Pyjeve

(shfuqizuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Neni 9

Strukturat e shërbimit pyjor

(ndryshuar pikat 1 dhe 2, me ligjin nr.9533, datë 15.5.2006, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Ministria përgjegjëse për pyjet është organi më i lartë politikëbërës në fushën e pyjeve dhe përgjigjet për hartimin e legjislacionit përkatës të pyjeve, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullosor kombëtar.

2. Strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkive janë organi administrativ i shërbimit pyjor dhe përgjigjen për sigurimin e mbrojtjes, për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit administrativ të bashkisë.

3. Punonjësit e shërbimit pyjor pajisen me uniformë (me shenja dalluese), me dokument identifikimi, me armatim, me tabela të ndalimit të automjeteve dhe me mjete të tjera teknike, të domosdoshme e të nevojshme për kryerjen e detyrës. Caktimi i rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve e të mjeteve të tjera caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Ministria përgjegjëse për pyjet

(ndryshuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Ministria përgjegjëse për pyjet është përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, si dhe miratimin e planeve të menaxhimit për fondin pyjor kombëtar.

2. Ministria përgjegjëse për pyjet:

2.1. Është organ i specializuar politikëbërës, me atribute teknike, menaxhuese, kontrolluese e këshillimore.

2.2. Siguron/ofron mbështetje teknike në fondin pyjor kombëtar dhe ka këto detyra:

a) qeverisjen politike të pyjeve dhe të tokave pyjore;

b) mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e pyjeve publike dhe private;

c) ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor kombëtar;

ç) mbajtjen dhe administrimin e të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit pyjor, të kadastrës pyjore, të projekteve, të financës, të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, të të dhënave bazë për tërësinë e fondit pyjor e kullosor dhe të tokave pyjore, si dhe të punimeve e përgjithësimeve statistikore;

d) ndjekjen e zbatimit të planeve të mbarështimit dhe të inventarizimit të pyjeve, të kullotave, të florës e të faunës së egër, si dhe të shmangies së sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve;

dh) ndjekjen, bashkëpunimin, harmonizimin dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore në pyje e kullota;

e) ndjekjen e përpunimit të metodologjive për mbledhjen e të dhënave të zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, përpunimin e këtyre të dhënave dhe përgatitjen e informacionit për publikun;

ë) sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;

f) kontrollin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota, pavarësisht nga burimi i financimit.

Neni 11

Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki

(ndryshuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki është organ i specializuar i këtij shërbimi në nivel vendor, me atribute teknike, menaxhuese e këshillimore, në përbërje të bashkisë.

2. Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki kryen shërbime teknike e publike në fondin pyjor vendor dhe ka këto detyra:

a) qeverisjen tërësore të pyjeve dhe të tokave pyjore;

b) mbledhjen e të dhënave për zhvillimin e pyjeve publike dhe private;

c) ruajtjen e ekuilibrit biologjik në fondin pyjor vendor;

ç) mbajtjen dhe administrimin e të gjitha dokumenteve për hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit të fondit pyjor privat brenda njësisë administrative të bashkisë;

d) të mbajë të dhëna të sëmundjeve, dëmtuesve dhe zjarreve në pyjet e kullotat e bashkisë;

dh) përgatitjen e projekteve për investimet në pyje e kullota;

e) drejtimin dhe mbikëqyrjen e punës për përmirësimin e zonave të gërryera dhe luftimin e gërryerjeve, të rrëshqitjeve e të ortekëve brenda territorit të bashkisë;

ë) ndjekjen, bashkëpunimin, harmonizimin dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore në pyje e kullota;

f) mbikëqyrjen e zhvillimit të florës e faunës së egër dhe propozimin e metodave për mbrojtjen e llojeve të rrezikuara, të rralla ose në rrezik;

g) sigurimin e mbështetjes teknike nëpërmjet këshillimit të pronarëve privatë dhe të komunitetit;

gj) organizimin e trajnimeve dhe të shërbimeve këshillimore për pronarët privatë;

h) kontrollin dhe marrjen në dorëzim të punimeve të kryera në pyje e kullota, pavarësisht nga burimi i financimit;

i) mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës në fondin pyjor bashkiak;

j) hartimin dhe zbatimin e një programi për trajnimin e punonjësve të shërbimit pyjor dhe aftësimin e tyre profesional;

k) mbështetjen e zhvillimit të agropylltarisë në bashki.

Neni 12

Funksioni dhe detyrat e Policisë Pyjore

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Policia Pyjore është organ i specializuar i shërbimit pyjor, me funksione kontrolluese. Struktura e Policisë Pyjore, gjatë kryerjes së shërbimit, përfiton status të njëjtë me atë të Policisë së Shtetit.

2. Policia Pyjore kryen këto detyra:

a) kontrollon zbatimin e dispozitave ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi për pyjet, kullotat, zonat e mbrojtura, florën e faunën e egër, veprimtarinë e gjuetisë dhe veprimtaritë e tjera që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar nga subjektet private e publike, juridike e fizike, si dhe propozon heqjen e licencave kur subjektet veprojnë në kundërshtim me këto dispozita;

b) parandalon, zbulon dhe lufton dëmtimin, pushtimin, shpërdorimin, tjetërsimin, shkretimin dhe degradimin e pyjeve e të tokës pyjore, cenimin nga ndërhyrjet e pakontrolluara në fondin pyjor dhe në mjedisin natyror;

c) organizon punën për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve;

ç) parandalon dhe merr masa në rastet e shfrytëzimit dhe të tregtimit të paligjshëm të materialit drusor, të prodhimeve pyjore e jopyjore, të krimit në sektorin e pyjeve, kullotave, zonat e mbrojtura e pyjet me funksion të veçantë, të florës e faunës së egër, të bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore e tanifere natyrore, të prodhimeve pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, si dhe çdo veprimtari tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj;

d) kontrollon veprimtaritë e subjekteve që grumbullojnë, përpunojnë dhe tregtojnë prodhimet e përftuara nga shfrytëzimi i pyjeve (trupa, lëndë ndërtimi, shtylla miniere, degë voze, dru zjarri, qymyr druri etj.) dhe prodhimet gjysmë të përpunuara (dërrasë, elemente etj.) në qendrat e përpunimit (gatrat, sharrat, cirkularet etj.) në magazinat dhe sheshet e depozitimit;

dh) bllokon veprimtarinë e ushtruar nga çdo person fizik a juridik, që nuk shlyen detyrimet ligjore në afatet e caktuara dhe/ose që nuk respekton kushtet e kontratave;

e) mbron dhe mbështet veprimtarinë e administratës menaxhuese të shërbimit pyjor;

ë) kryen, në bashkëpunim me organet e Policisë së Shtetit, organet tatimore, doganore e financiare, të Policisë së Ndërtimit dhe me organet e qeverisjes vendore, veprimtaritë dhe funksionet që parashikohen nga ligje të tjera;

f) kontrollon zbatimin e punimeve që kryhen sipas projekteve në pyje, kullota, rezervate të gjuetisë dhe zona të mbrojtura;

g) ndërpret të gjitha punimet, që nuk janë në përputhje me projektet e hartuara e të parashikuara në kontratat e nënshkruara;

gj) kontrollon e mbikëqyr mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit nga subjektet private e publike, juridike ose fizike, që ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor kombëtar;

h) kontrollon zbatimin e rregullave të sigurisë dhe të shëndetit të punëtorëve, që punojnë në pyje;

i) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për përdorimin dhe vjeljen e prodhimeve pyjore nga burimet pyjore e jopyjore, në pronësi apo në përdorim të bashkive ose në pronësi private.

3. Inspektorët e Policisë Pyjore kanë të gjitha të drejtat për të hyrë, kontrolluar, inspektuar dhe për të marrë masat përkatëse të procedimit, si dhe të bllokimit apo sekuestrimit, në rastet e shkeljes së ligjit. Inspektorët e Policisë Pyjore gjatë kryerjes së detyrës gëzojnë atributet e Policisë Gjyqësore.

KREU IV
FUNKSIONET E PYLLIT, PËRBËRJA E PRONËSIA E FONDIT PYJOR KOMBËTAR DHE KADASTRA

Neni 13
Funksionet e pyllit

(shtuar një paragraf, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Funksionet e pyllit janë:

a) ekonomike, që kanë të bëjnë me prodhimin e materialit drusor dhe jodrusor, të bimëve mjekësore, aromatike e eterovajore, si dhe me habitatet e shpendëve dhe të kafshëve të egra apo me prodhime të tjera natyrore të fondit pyjor kombëtar;

b) ekologjike, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e florës dhe faunës së egër, të ruajtjes së burimeve gjenetike, hidrologjike, kundër gërryerjes e biotipike dhe me mbrojtjen e parcelave pyjore eksperimentale;

c) publike, që kanë të bëjnë me veprimtaritë mbrojtëse, argëtuese, çlodhëse, sportive, turistike, edukative, higjieno-sanitare, estetike apo kërkimore e shkencore.

Pyjet janë edhe objekt i sekuestrimit të karbonit. Ministria është organi përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Protokollit të Kiotos. Karboni i sekuestruar llogaritet dhe tregtohet, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Protokollin e Kiotos, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 14
Përbërja e fondit pyjor kombëtar

Fondi pyjor kombëtar përbëhet nga këto formacione bimore e jobimore:

a) pyjet dhe drurët pyjorë;

b) shkurret;

c) sipërfaqet e zëna nga brezat pyjorë mbrojtës, grupet e veçuara të drurëve;

ç) bimësia barishtore, mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore;

d) tokat pyjore, bujqësore (të dhëna në përdorim ose në pronësi të organeve të shërbimit pyjor), liqenet natyrore, tokat e lagëta dhe lagunat (për mbarështimin dhe zhvillimin e faunës së egër, pasuri kombëtare, dhe që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me fondin pyjor);

dh) sipërfaqet e zhveshura si çeltirat, shkëmbinjtë, dunat e ranishtet, që ndodhen në sipërfaqen pyjore dhe pranë tyre (jo më larg se 500 m), por që krijojnë një mjedis ekologjik të harmonizuar me të;

e) infrastruktura rrugore e komunikimit me të gjitha elementet bashkëshoqëruese, pritat e pendat, lerat, koritat, çezmat, rrethimet apo gardhimet në zonat e mbrojtura, në pyjet me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë, si dhe lehtësitë e krijuara e të ngritura për personelin e shërbimit pyjor dhe për pritjen e vizitorëve në to;

ë) ndërtesat, zyrat, magazinat, depot, stacionet pyjore, qendrat e informimit dhe të pritjes së vizitorëve, ujësjellësat, linjat elektrike e telefonike (të ndërtuara nga shërbimi pyjor apo të dhëna në pronësi të tyre), makinat, tabelat, shenjat e ndryshme treguese e sinjalizuese dhe ato të mbarështimit pyjor.

Neni 15

Pronësia e fondit pyjor kombëtar

(shtuar pika 5, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007 dhe me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Fondi pyjor kombëtar, sipas pronësisë, ndahet në:

a) fond pyjor në pronësi publike;

b) fond pyjor në pronësi private.

2. Shfuqizuar.

3. Fondi pyjor publik ndahet në:

a) pyje e toka pyjore në pronësi të bashkisë brenda territorit administrativ ku ato ndodhen;

b) zona të mbrojtura, në pronësi të ministrisë përgjegjëse për pyjet.

4. Fondi pyjor privat përbëhet nga:

a) pyje dhe toka pyjore në pronësi private;

b) drurë dhe grupe drurësh, që ndodhen brenda kufijve të tokave në pronësi private, pyje të reja, të cilat krijohen në këto toka, dhe pjesët e fondit pyjor pronësi private.

5. Kuotat e karbonit, në procesin e sekuestrimit të tij, u përkasin pronarëve, sipas pronësisë që kanë mbi fondin pyjor.

Neni 16

Kadastra Kombëtare e Fondit Pyjor

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Fondi pyjor kombëtar dhe infrastruktura integrale e tij regjistrohen në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë referuar pronësisë së përcaktuar në pikën 3 të nenit 15 të ligjit.

2. Fondi pyjor publik organizohet e trajtohet sipas ekonomive pyjore ose pellgjeve ujëmbledhëse.

3. Kriteret për krijimin dhe organizimin e masiveve pyjore ose të pellgjeve ujëmbledhëse, si njësi prodhimi, për sigurimin e vazhdimësisë së procesit të prodhimit pyjor në nivel rajoni, përcaktohen nga ministria përgjegjëse për pyjet.

4. Fondi pyjor kombëtar trajtohet në përputhje me planet e mbarështimit dhe të inventarizimit.

5. Inventarizimi i pyjeve kryhet për një periudhë jo më pak se 10 vjet, sipas kritereve e udhëzimeve të përcaktuara me urdhër të ministri përgjegjës për pyjet.

6. Të dhënat e kadastrës së fondit pyjor pasqyrohen çdo vit nga strukturat në varësi të ministrisë përgjegjëse për pyjet, nëpërmjet programeve e sistemeve kompjuterike, duke krijuar bazën e të dhënave në shkallë vendi, qarku dhe sipas ekonomive pyjore apo pellgjeve ujëmbledhëse.

7. Kadastra Kombëtare e Fondit Pyjor është një regjistër zyrtar, ku shënohen të dhënat përkatëse për mënyrën e qeverisjes dhe ndryshimet periodike të fondit pyjor e kullosor.

8. Rregullat e hollësishme për krijimin dhe mbajtjen e Kadastrës Kombëtare të Fondit Pyjor, për regjistrimin, përditësimin dhe ndryshimet në gjendjen e tij, miratohen nga ministri përgjegjës për pyjet.

Neni 17

Heqja e sipërfaqeve (tokave) nga fondi pyjor kombëtar

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 1 dhe shtuar pikat 1/1 dhe 1/2 me ligjin nr. 15/2012, datë 16.2.2012)

1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t'u kthyer në truall, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të

shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit e të qendrave të banuara në zonat rurale, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo ato shëndetësore ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike apo hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake, qendra industriale, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha, me miratimin e ministrit;

b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha, me ligj të veçantë.

1/1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionet e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar. Ndryshimi i formës së përdorimit të fondit pyjor në kategorinë e resursit të tokës bujqësore, pavarësisht madhësisë së sipërfaqes, bëhet vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata.

1/2. Kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisje vendore, në fond pyjor, (pyll), dhe regjistrimi në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore. Kërkesa paraqitet pranë ministrisë veprimtaria e së cilës mbulon pyjet, dhe miratohet nga ministri përkatës.

2. Rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Kufijtë e fondit pyjor kombëtar janë të përhershëm, të përcaktuar qartë dhe të shënuar në terren, të hedhur në hartë me qëllim që të sigurohet mbikëqyrja e vazhdueshme e tyre, për të realizuar mbrojtjen e frytshme nga degradimi, tjetërsimi, pushtimi dhe shkretimi.

Neni 18

Ndryshime në Kadastrën Kombëtare të Fondit Pyjor

1. Pronari duhet të marrë miratimin e organeve të shërbimit pyjor përpara ndryshimeve (rritjen ose zvogëlimin e sipërfaqes dhe të vëllimit, ripyllëzimin) në fondin pyjor dhe në tokën pyjore që zotëron.

2. Kur në fondin pyjor ose tokën pyjore, nga KRRTRSH-ja miratohen studime urbanistike për zhvillime turistike, ministria përgjegjëse për pyjet pasi merr dijeni, bën shënimin përkatës në kadastrën e pyjeve.

3. Pronarët e fondit pyjor dhe të tokës pyjore, brenda 6 muajve nga data e konstatimit, kanë detyrimin që, për ndryshimet e bëra në fondin pyjor të njoftojnë struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki dhe kjo e fundit zyrën kadastrale të ministria përgjegjëse për pyjet, për të bërë përditësimin në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve, ndërsa për ndryshimet e ndodhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të papërditësuara, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit njofton drejtorinë përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet për miratimin e veprimtarive në fushën e turizmit, të cilat zhvillohen në fondin pyjor, në përputhje me ligjin "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin".

Me miratimin e lejes së ndërtimit për zhvillime turistike në sipërfaqet e fondit pyjor apo të tokës pyjore, këshilli i rregullimit të territorit të bashkisë njofton shërbimin pyjor për të bërë përditësimin në kadastrën e pyjeve.

Neni 19

Dhënia në përdorim e fondit pyjor kombëtar

(ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar paragrafi i tretë i pikës 1, me ligjin nr.9989, datë 15.9.2008, shtuar pika 1/1, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Pjesë të fondit pyjor kombëtar dhe të pyjeve e tokave pyjore mund të jepen në përdorim për punë kërkimore e studimore, për mbarështim të florës dhe faunës së egër e për gjueti, për baza didaktike apo eksperimentale, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike.

Pjesë jopyjore të fondit pyjor kombëtar mund të jepen në përdorim për veprimtari biznesi dhe për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, gjeologjike e minerare, për gurore e kariera, pa cenuar vlerat dhe funksionet e tyre.

Ministri miraton dhe shpall listën e vendeve ose të shesheve të fondit pyjor publik, ku mund të ushtrohen këto veprimtari, ndërsa për pyjet komunale, listën e shpallin bashkitë.

1/1. Dhënia në përdorim, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshihet në kategorinë III.4, të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave në vijim, të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra sipas ndarjes në nënkategori.

2. Plotësimi i nevojave të banorëve të komunave me lëndë dhe dru zjarri, për sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë e për kullotje, si dhe për grumbullimin e prodhimeve drusore e jodrusore bëhet nga pyjet komunale. Për komunat, që nuk kanë pyje komunale, këto nevoja mund të plotësohen nga pyjet shtetërore, sipas rregullave dhe procedurave të udhëzimit, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Dhënia në përdorim e pjesëve të fondit pyjor bashkiak bëhet në bazë të kontratave, të nënshkruara nga kryetari i bashkisë. Kontratat përfundojnë në çastin kur KKT-ja miraton, për sipërfaqen e fondit pyjor, objekt kontrate, studime urbanistike. Rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar caktohen me udhëzim të ministrit.

4. Kur në sipërfaqet e fondit pyjor ose toka pyjore realizohen studime urbanistike për zhvillime turistike, me miratimin e studimit urbanistik nga KRRTRSH-ja, në këto sipërfaqe zbatohen dispozitat e ligjit "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin".

KREU V
RUAJTJA DHE ADMINISTRIMI I FONDIT PYJOR KOMBËTAR

Neni 20

Ruajtja e fondit pyjor kombëtar

1. Republika e Shqipërisë zbaton parimet dhe normat e konventave, të marrëveshjeve e traktateve ndërkombëtare, në të cilat është palë, si dhe merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranuara të së drejtës ndërkombëtare për pyjet.

2. Ruajtja e pyjeve dhe e mjedisit pyjor nga ndotja dhe dëmtimi me lëndë të gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme, që krijohen ose shkarkohen nga objekte a veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, shoqërore e kulturore, ushtarake, të transportit ose nga veprimtari të tjera, që cenojnë ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore ose dëmtojnë të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, të pushtetit vendor dhe për personat fizikë a juridikë, vendas e të huaj.

3. Personat fizikë a juridikë, që kanë në pronësi, në administrim ose në përdorim pyje, grumbuj drurësh ose dru pyjorë, brenda ose jashtë fondit pyjor kombëtar, janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e tyre.

4. Mbrojtja dhe miradministrimi i fondit pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, nga dëmtimi, prerjet ose kullotjet pa leje, sëmundjet dhe insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi janë detyrë e përhershme e organeve të shërbimit pyjor dhe e organeve të qeverisjes vendore, pronarëve, subjekteve që kryejnë veprimtari në këtë fond dhe, sipas rastit, edhe të strukturave të tjera shtetërore (Policia e Shtetit, ajo financiare, doganore, e ndërtimit), të ngarkuara me ligje të tjera.

5. Strukturat e organeve të shërbimit pyjor përgatisin skemën për monitorimin afatgjatë të kushteve të pyjeve, ku përcaktohen vazhdimësia dhe zhvillimi i mëtejshëm i tyre, masat për mbrojtjen e pyjeve dhe të mjedisit pyjor nga ndotja atmosferike, ruajtja e ekuilibrave të sistemeve ekologjike natyrore, duke shmangur sëmundjet dhe shfaqjen e insekteve në pyje, si dhe masat parandaluese nga zjarri.

6. Mbrojtja e mbulesës pyjore dhe e ekosistemeve pyjore të vendit, për të ruajtur prodhimtarinë, diversitetin biologjik dhe peizazhin është një bazë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të sektorit pyjor e të kullotave.

7. Në rast se në fondin pyjor ose në një pjesë pylli dhe në shkurre bie zjarr, organet e shërbimit pyjor, organet e bashkive, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij.

8. Shpenzimet e nevojshme për shuarjen e zjarreve përballohen nga organi, që ka në pronësi pyllin ose kullotën, dhe nga Buxheti i Shtetit, në rastin e një prone private me rëndësi kombëtare, historike, kulturore, arkeologjike, ekologjike etj.

9. Organet e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me bashkitë dhe me strukturat e shërbimit për mbrojtjen nga zjarri dhe të shpëtimit, organizojnë punën për parandalimin e zjarrit në fondin pyjor kombëtar.

Rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive të shuarjes së zjarreve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Në zonat pyjore, të caktuara për çlodhje, argëtim, turizëm dhe për pritjen e publikut, organet e shërbimit pyjor caktojnë vendqëndrimet dhe rrugët e lëvizjes, si dhe vendet ku mund të lejohet ndezja e zjarreve.

11. Në fondin pyjor kombëtar mbrohen dhe janë të patjetërsueshme të gjitha veprat hidroteknike (pritat malore, gardhet, pendat), burimet ujore, liqenet natyrore, kënetat e lagunat, përrenjtë e përroskat, veprat e ujit, koritat e ngrehinat e ndërtuara etj., të cilat krijojnë një kompleks të domosdoshëm natyror e të harmonizuar me pyjet e tokën pyjore.

12. Procedurat, rregullat, pagesa për mbrojtjen e fondit pyjor privat nga Policia Pyjore dhe marrëveshja tip caktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për pyjet.

Neni 21

Rehabilitimi dhe përdorimi i fondit pyjor kombëtar

(ndryshuar pika 12, me ligjin nr.9533, datë 15.5.2006)

1. Punimet mbrojtëse dhe ripërtëritëse në fondin pyjor kombëtar kryhen për të parandaluar ose kufizuar veprimet shkatërruese në pyll.

2. Masa për zhvillimin dhe kryerjen e punimeve mbrojtëse e ripërtëritëse ndërmarrin edhe pronarët, për drurët pyjorë, që ndodhen në tokat pyjore, në tokat bujqësore, në afërsi të pyllit, si dhe për drurët, që ndodhen jashtë fondit pyjor kombëtar.

3. Rritja e prodhimtarisë së fondit pyjor kombëtar, nëpërmjet ripërtëritjes së pyjeve të shfrytëzuara, përmirësimit të pyjeve ekzistuese, zbatimit të punimeve të mirëmbajtjes dhe atyre sanitare, në përputhje me funksionin e pyjeve, të nevojave ekonomike dhe të shtimit të sipërfaqes së fondit pyjor kombëtar, nëpërmjet pyllëzimit të tokave bujqësore, të braktisura e të pandara, të vendeve të zhveshura e të gërryera, të tokave ranore e zhavorrishte e të tjera të kësaj kategorie, është detyrë e administruesve dhe e përdoruesve të këtyre tokave.

4. Rehabilitimi i ekosistemeve pyjore, kullosore, i tokave pyjore të degraduara e të braktisura, i peizazhit pyjor, i habitateve të florës e faunës së egër, kryhet nën drejtimin e strukturave të organeve të shërbimit pyjor.

5. Ruajtja e ekuilibrit mjedisor, nëpërmjet ruajtjes ekologjike në ndërhyrjet në ekosistemet pyjore e kullosore dhe përdorimi i standardeve bashkëkohore për përtëritjen e tyre dhe të mjedisit natyror, është detyrë e organeve të shërbimit pyjor, e bashkive dhe e pronarëve privatë.

6. Rehabilitimi i terreneve të degraduara kryhet nëpërmjet nxitjes dhe mbështetjes së agropylltarisë në pronat publike dhe private.

7. Shpenzimet dhe sigurimi i mjeteve e i pajisjeve për mbrojtjen e fondit pyjor kombëtar nga zjarret, ndotjet dhe për luftimin e sëmundjeve, të insekteve e të barërave të këqija dhe parazitare përballohen nga Buxheti i Shtetit, në bazë të kritereve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

8. Nuk lejohen grumbullimi dhe shitja e prodhimeve drusore e jodrusore jashtë mundësive të tyre prodhuese e biologjike. Në raste të emergjencës për përballimin e fatkeqësive e të katastrofave natyrore, sasitë që do të përdoren për grumbullimin dhe shitjen e këtyre prodhimeve, jashtë mundësisë prodhuese e biologjike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Krasitja për gjethe, kullotja e bagëtisë dhe kositja apo grumbullimi i barit në fondin pyjor publik bëhen me leje të organeve të shërbimit pyjor, ndërsa për pyjet në përdorim të bashkive e nga administrata e saj, kundrejt pagesës përkatëse.

10. Kullotja dhe kalimi i bagëtive në pyjet publike, në pyllëzimet e reja, në ngastrat pyjore të shfrytëzuara a në ripërtëritje e sipër, në pyjet e ricunguara, në pyjet mbrojtëse e me funksion të veçantë, në rezervatet e gjuetisë e të mbarështimit të faunës së egër, si dhe në ato të farërave kryhen në përputhje me rregullat e caktuara nga ministria përgjegjëse për pyjet.

11. Gërmimet në fondin pyjor, publik e privat, dhe në rrjetin e përrenjve për të nxjerrë humus, gurë, rërë, zhavorr, plisa bari ose të tjera si këto, vendosja e kaminave të qymyrit të drurit dhe e eshkës së kovaçit, të furrave të gëlqeres apo hapja e guroreve bëhen me leje të organeve të shërbimit pyjor dhe të institucioneve të tjera, të ngarkuara me ligj të veçantë, në kohën dhe vendin e caktuar, kundrejt pagesës.

12. Ministria përgjegjëse për pyjet jep lejen për ushtrimin e veprimtarive në fondin pyjor, duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka të drejtë të pajisë subjektet fizike e juridike me lejet përkatëse të ushtrimit të veprimtarive në fushën që mbulon.

13. Qëndrimi i automjeteve, vendosja e rulotave dhe qëndrimi i kafshëve në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në rezervatet e mbarështimit të florës e faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor, me rëndësi të veçantë, bëhen sipas rregullave të caktuara nga ministri përgjegjës për pyjet.

14. Lejimi i ndërtimeve të thjeshta, jo me karakter tregtar, i ngrehinave, i gardhimeve dhe kufizimi i lëvizjeve të vizitorëve, brenda territoreve të rrethuara të pjesëve të fondit pyjor publik dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë, kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ministri përgjegjës për pyjet.

15. Vendosja në fondin pyjor publik e kampingjeve, e çadrave dhe e strehimeve të lëvizshme (rulotat) ose e objekteve të tjera të kësaj natyre bëhet në vendet e caktuara nga organet e shërbimit pyjor.

16. Organet e shërbimit pyjor, kur vërejnë se bimët dhe prodhimet pyjore janë të infektuara nga parazitë karantinorë dhe se janë kryer shkelje të dispozitave ligjore bëjnë menjëherë bllokimin dhe njoftojnë jo vetëm pronarin ose përdoruesin, por edhe eprorët për arsyet e bllokimit.

17. Pjesë apo ekonomi pyjore lejohen të trajtohen edhe për mbarështimin e faunës së egër dhe për ushtrimin e veprimtarisë turistike e të gjuetisë sportive.

18. Personat juridikë e fizikë, të cilët kryejnë veprimtari të lejuara në fondin pyjor publik, pavarësisht nga kontratat që kanë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, janë të detyruar të lidhin kontratë mirëmbajtjeje dhe përdorimi të zonave të gjelbra pyjore, në përputhje me studimet e

miratuara nga KRRTRSH-ja, në bashkërendim me organet e shërbimit pyjor, për sipërfaqen pyjore a kullosore të zënë me ndërtime dhe për territorin që përdorin apo që kanë me qira.

Për administrimin e fondit pyjor, brenda sipërfaqes së miratuar për zhvillimin e turizmit, subjekti përkatës lidh marrëveshje për shërbimet dhe mirëmbajtjen e këtij fondi me ministrinë përgjegjëse për pyjet për ruajtjen nga dëmtimet dhe prerjet e paligjshme, nga sëmundjet dhe insektet, nga zjarret, si dhe për llojin e pemëve të reja që do të mbillen në territorin e caktuar.

Tarifat për shërbimet e mësipërme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

19. Agjencitë turistike dhe të udhëtimit, që kryejnë veprimtari turistike në fondin pyjor publik, në zonat pyjore të lejuara nga organet e shërbimit pyjor, zbatojnë parimet mjedisore dhe rregullat kombëtare e ndërkombëtare në këtë fushë dhe kujdesen që turistët të respektojnë kodet e sjelljes në natyrë.

20. Kryerja e manovrave ushtarake në fondin pyjor publik bëhet pas vlerësimit të ndikimit në mjedis të këtyre manovrave, me leje të organeve të shërbimit pyjor dhe të agjencive rajonale të mjedisit, në të cilën përcaktohen kushtet për zvogëlimin e efekteve të dëmshme në mjedisin pyjor.

Neni 22

Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor kombëtar

1. Pyjet në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pasuri kombëtare. Shteti garanton me këtë ligj barazinë e marrëdhënieve të pronësisë në fondin pyjor kombëtar.

2. Administrimi, zhvillimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi i fondit pyjor kombëtar janë detyra të strukturave të organeve të shërbimit pyjor, të pronarëve, të institucioneve të tjera shtetërore dhe të organeve të pushtetit vendor.

3. Qeverisja dhe administrimi i fondit pyjor kombëtar (publik, në përdorim a në pronësi të bashkive dhe privat) bëhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Fondi pyjor publik, vendor a privat, administrohet e trajtohet sipas planeve të mbarështimit, të inventarizimit dhe të funksioneve të këtij fondi.

5. Të gjithë pronarët, administruesit, qiramarrësit dhe përdoruesit e fondit pyjor kombëtar e të tokës pyjore detyrohen të kujdesen, vazhdimisht, për trajtimin dhe zhvillimin e fondit pyjor kombëtar dhe për mbrojtjen e mjedisit pyjor.

6. Administrimi, shtimi dhe trajtimi shkencor i pyjeve mbrojtëse dhe i atyre me funksion të veçantë, pavarësisht ku ndodhen, i drurëve e i shkurreve me vlera të veçanta, i bimëve mjekësore e tanifere, brenda fondit pyjor publik dhe atij vendor, bëhen nën kujdesin e organeve të shërbimit pyjor.

7. Krijimi i pyjeve të reja, ngritja e zonave të reja apo zgjerimi i zonave ekzistuese pyjore kryhen në mbështetje të projekteve dhe me leje të organeve të shërbimit pyjor.

8. Drurët, grumbujt e drurëve e të shkurreve, parqet dhe lulishtet në qytete, në qendra të banuara e në qendra prodhimi mbrohen dhe trajtohen nga pronarët e tyre të ligjshëm.

9. Sipërfaqet dhe objektet në pronësi private, të cilat përfshihen në fondin pyjor publik, mbeten pronë e pronarit të ligjshëm. Ato administrohen e përdoren prej tij dhe në rastet kur do të zhvillohen veprimtari në to, menaxhohen sipas kërkesave të planit të mbarështimit pyjor.

10. Shteti nxit nismat individuale a kolektive për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, nëpërmjet sistemit të kredive lehtësuese, të përdorimit afatgjatë, deri në privatizimin e tyre.

11. Çdo vit, në Buxhetin e Shtetit planifikohen fonde për investime, për rimëkëmbjen e integritetit ekologjik të pyjeve e të kullotave, për ruajtjen dhe përmirësimin e ekosistemeve, të habitateve, të gjendjes mjedisore dhe të biodiversitetit pyjor.

Neni 23

Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor në pronësi të bashkive

(ndryshuar pika 1, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve vendore apo i pjesëve të tyre bëhen nga bashkitë, sipas planeve të mbarështimit dhe të dispozitave të këtij ligji.

2. Për një administrim të qëndrueshëm e shumëfunksional të fondit pyjor vendor, për rregullimin e përdorimit e të shfrytëzimit të pyjeve, të kullotave dhe të burimeve të tjera pyjore e jopyjore, për mbrojtjen nga zjarri, dëmtuesit etj., brenda territorit administrativ të bashkive, krijohen njësitë tekniko-administrative, në varësi të drejtpërdrejtë të organeve të qeverisjes vendore. Strukturat e ministrisë përgjegjëse për pyjet ndihmojnë, kontrollojnë, këshillojnë dhe sigurojnë mbështetjen teknike për këto njësi dhe për shoqatat e përdoruesve të pyjeve.

3. Organet e qeverisjes vendore kanë për detyrë të marrin masa dhe të planifikojnë fonde për investimet në pyjet, në territorin që ata mbulojnë, për përmirësimin dhe planifikimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregtimit të prodhimeve pyjore, si dhe për krijimin e sektorit të agropylltarisë.

4. Shteti mbështet nismat individuale a kolektive të bashkive për shtimin e sipërfaqes së pyjeve, për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, në pronësi të tyre, nëpërmjet sistemit të kredive me kushte lehtësuese.

5. Bashkia, çdo vit, nga të ardhurat e realizuara planifikon fonde për ruajtjen, mirëmbajtjen, kryerjen e punimeve silvikulturore dhe përgjigjet për trajtimin shkencor të tyre.

6. Vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera nga pyjet vendore bëhet në përputhje me këtë ligj.

7. Kriteret e transferimit dhe përdorimit të pyjeve nga bashkitë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor privat

1. Administrimi dhe zhvillimi i fondit pyjor privat bëhen nga pronarët, në përputhje me planet e thjeshta të mbarështimit, të miratuara nga shërbimi pyjor.

2. Pronari privat nuk mund të vendosë e të kryejë një shndërrim të pyjeve, të kulturave pyjore apo të ndryshojë zërin kadastral, në pronën pyjore të tij, pa marrë, paraprakisht, miratimin e organit përkatës të shërbimit pyjor.

3. Shteti, brenda mundësive, mjeteve e fondeve që ka, mbështet plotësimin e nismës dhe të përgjegjësive private, individuale e kolektive, për zgjerimin e sipërfaqes së pyjeve private, për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e burimeve pyjore dhe për krijimin e fermave private pyjore.

4. Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve, i drurëve pyjorë apo i grumbujve pyjorë të veçuar, në pronësi të komuniteteve fetare, bëhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

5. Vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera nga pyjet private bëhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 25

Pyjet me funksion mbrojtës dhe të veçantë

1. Pyjet, drurët dhe pjesët e fondit pyjor publik, të shpallura me funksion mbrojtës e të veçantë (mbrojtës të klimës, tokës, ujërave, ajrit, të elementeve higjieno-shëndetësorë, me funksion të veçantë pushimi, çlodhjeje, edukimi, turizmi, estetikë, kërkimore dhe shkencore, mbrojtës të natyrës dhe trashëgimisë natyrore e kulturore), ruhen, zhvillohen, mbarështohen dhe administrohen, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit "Për trashëgiminë kulturore".

2. Kriteret për shpalljen e pyllit me funksion mbrojtës ose të veçantë përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për pyjet.

3. Në pyjet apo në ato pjesë të fondit pyjor kombëtar, me funksion mbrojtës ose të veçantë, kryhen punime përkujdesjeje dhe të prerjeve sanitare, në mbështetje të projekteve të hartuara dhe pas miratimit nga organet e shërbimit pyjor.

4. Pyjet private ose pjesë të tyre mund të përfshihen në listën e pyjeve dhe të pjesëve të fondit pyjor kombëtar, me funksion mbrojtës ose të veçantë, pas marrjes me shkrim të mendimit të pronarit të tyre të ligjshëm.

5. Ministria përgjegjëse për pyjet publikon listën e pyjeve dhe të pjesëve të fondit pyjor kombëtar, me funksion mbrojtës ose të veçantë.

KREU VI
TRAJTIMI, SHFRYTËZIMI DHE SHITJA E MATERIALIT DRUSOR DHE E PRODHIMEVE PYJORE E JOPYJORE

Neni 26
Trajtimi dhe shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar

(ndryshuar pikat 2, 3 e 4, shtuar pikat 15 e 16, me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 2 me ligjin nr.9989, datë 15.9.2008, shtuar pika 17, me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009, shfuqizuar pika 6 dhe ndryshuar pika 9 me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Shfrytëzimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera pyjore dhe jopyjore lejohet në fondin pyjor shtetëror, vendor ose privat, për qëllime të përfitimit ekonomik dhe vetëm nëpërmjet kryerjes së punimeve të parashikuara në planet e mbarështimit.

2. Personat fizikë dhe juridikë mund ta trajtojnë dhe shfrytëzojnë fondin pyjor kombëtar vetëm kur kanë dalë fitues në procedurat e konkurrimit publik dhe kur lidhin kontratën me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor ose me bashkitë. Kërkesat, që duhet të plotësojnë subjektet për pjesëmarrje në konkurrimin publik, përcaktohen me udhëzim të ministrit. Të drejtat, që sigurohen nga kontrata për trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar, nuk mund t'u transferohen të tretëve. Subjektet, që kanë lidhur kontratën, mund të ndërtojnë ose të vendosin instalime të përkohshme, sipas skemave teknologjike, të miratuara nga struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

3. Materiali drusor, që shfrytëzohet çdo vit nga fondi pyjor kombëtar, caktohet brenda mundësive vjetore të trajtimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, të përcaktuara në planet e mbarështimit, ndërsa në pyjet, me funksion mbrojtës e të veçantë, lejohet vetëm në rastet kur kryhen punimet e përkujdesjes dhe të prerjeve sanitare.

4. Shfrytëzimi i ngastrave dhe i nënngastrave lejohet vetëm kur kërkohet teknikisht, në rastet e prerjeve farore, dritësuese, përfundimtare apo prerjet në pyjet e dëmtuara nga katastrofat natyrore apo zjarret, nën kontrollin e organeve të shërbimit pyjor.

5. Sipërfaqet e pyjeve të larta përshkohen me prerje kulturore, sipas fazës së zhvillimit, në të cilën gjenden, dhe të kërkesave të silvikulturës.

6. Shfuqizuar.

7. Vjelja e prodhimeve pyjore në pyjet private kryhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore, duke mos cenuar mbrojtjen e tokës dhe të elementeve klimatike, ekologjike e shoqërore. Pronari, paraprakisht, duhet të sigurojë lejen përkatëse dhe damkimin e drurëve prej organeve të shërbimit pyjor.

8. Krijimi i rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë dhe ruajtja e trajtimi i pyjeve të virgjra ose pothuajse të virgjra, duke i kaluar në konservim të plotë, bëhen në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki çdo vit hartojnë dhe dërgojnë për miratim në ministrinë përgjegjëse për pyjet planin e shfrytëzimit të pyjeve dhe të prodhimeve të

dyta pyjore e jopyjore. Drejtoria përkatëse e ministrisë përgjegjëse për pyjet kontrollon zbatimin e këtij plani.

10. Shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar organizohet në bazë të vitit pyjor, i cili fillon në datën 1 tetor.

Këshilli i Ministrave cakton kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore.

11. Prerja e drurëve pyjorë në fondin pyjor kombëtar bëhet pas shënimit të tyre me damkë të veçantë nga organet e shërbimit pyjor. Ministri përgjegjës për pyjet, me udhëzim të veçantë, përcakton mënyrën e përdorimit, madhësinë dhe formën e çekiç-damkës.

12. Në trajtimin dhe shfrytëzimin e fondit pyjor publik përdorimi i standardeve për prerjet vjetore të lejueshme, ciklet e prerjeve, teknikat e shfrytëzimit dhe infrastruktura janë të detyrueshme.

13. Operacionet e trajtimit dhe të shfrytëzimit të pyjeve synojnë mbrojtjen e mjedisit pyjor e të biodiversitetit.

14. Grumbullimi i prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj., i thuprave të shelgut, frashërit, vërrit etj., i rrëshirës së pishës, i halave e gjetheve, i rrënjëve e lëvores, i luleve, frutave pyjore e sythave, i bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, i kërpudhave dhe i nënprodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, u lejohet personave juridikë e fizikë, të pajisur me lejen përkatëse, të lëshuar nga organet e shërbimit pyjor dhe në mbështetje të kritereve dhe të kontingjenteve të caktuara nga ministria përgjegjëse për pyjet.

15. Kur subjekti privat i specializuar kërkon të ndërtojë, me shpenzimet e veta, rrugën, për shfrytëzimin e ngastrave e të nënngastrave pa rrugë autopyjore, drejtoria përkatëse pyjore kompenson shpenzimet për ndërtimin e rrugës, duke bërë korrektimin e tarifave bazë, në varësi të investimeve të kryera për m^3 lëndë drusore në këmbë. Në këto raste, subjekti gëzon të drejtën e shfrytëzimit të tyre deri në prerjet përfundimtare, të përcaktuara në planet e mbarështimit.

16. Kur subjekti privat i specializuar kërkon të marrë sipërfaqe të gjëra nga fondi pyjor, për afate të gjata kohore për të rehabilituar pyjet, kërkesa shqyrtohet, në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet."

17. Dhënia në përdorim e të mirave publike, sipas këtij neni, nëse është kompetencë e institucioneve qendrore, përfshihet në kategorinë III.4 të shtojcës së ligjit për licencat dhe bëhet sipas ligjit për licencat ose sipas dispozitave të parashikuara në këtë nen dhe në nenet në vijim të këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos për përdorimin e njërës nga këto dy mënyra, sipas ndarjes në nënkategori.

Neni 26/1

(shtuar me ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009)

Veprimtaritë e shfrytëzimit në fondin pyjor, përveçse kur kryhen nga banorët dhe për nevojat e tyre, sipas këtij ligji, mund të realizohen vetëm nga individë të certifikuar, në përputhje me procedurat e miratuara nga Këshilli i Ministrave. Kur këto veprimtari kryhen nga subjekte, juridike ose fizike, tregtare, u nënshtrohen licencimit dhe përfshihen në kategorinë III.7, të shtojcës së ligjit për licencat. Licencimi i këtyre veprimtarive bëhet sipas ligjit për licencat.

Neni 27

Shitja e materialit drusor dhe e prodhimeve pyjore e jopyjore

(ndryshuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007, ndryshuar pika 5 dhe 7, me ligjin nr.9989, datë 15.9.2008)

1. Shitja e materialit drusor në pyjet publike bëhet nga organet e shërbimit pyjor, me ankand, në dy mënyra:

a) në formën e asortimenteve të gatshme, në anë të rrugës ose në sheshet e depozitimit;

b) në këmbë (të paprera).

2. Ankandet për shitjen e asortimenteve të gatshme në anë të rrugës, të prodhuara nga subjektet private, për llogari të shërbimit pyjor, zhvillohen vetëm për pyjet e reja kur trajtohen me prerje kulturale, me rallime, të tipit I e II, si dhe për zonat e mbrojtura, në varësi të nevojave të trajtimit të ngastrave e nënngastrave pyjore, të fondeve të planifikuara për këtë qëllim dhe të kërkesave të tregut.

3. Shfrytëzimi dhe prodhimi i asortimenteve të gatshme dhe magazinimi i tyre në anë të rrugës apo në sheshe depozitimi realizohen nga subjekte private, të përzgjedhura, nëpërmjet tenderave, të organizuara nga organet e shërbimit pyjor, në përputhje me rregullat dhe procedurat e legjislacionit në fuqi. Tenderat zhvillohen për ngastrat dhe nënngastrat, për të cilat janë përgatitur projektet tekniko-ekonomike të trajtimit apo të shfrytëzimit dhe vetëm në rastet kur garantohen efektiviteti ekonomik, miradministrimi dhe ruajtja e asortimenteve deri në shitjen e tyre.

4. Ankandet për shitjen e lëndës drusore në këmbë zhvillohen për pyjet e larta trungishte, pyjet e ulëta cungishte, si dhe për shkurret, që kanë arritur moshën e shfrytëzueshmërisë, sipas fazave të prerjes, të përcaktuara në planet e mbarështimit.

5. Kërkesat dhe rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore përcaktohen me udhëzim të ministrit.

6. Materialet drusore dhe çdo prodhim tjetër me origjinë pyjore, të sekuestruara në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit dhe të tregtimit, ruhen nga subjektet, të cilave u janë sekuestruar, deri në shitjen e tyre nga organet e shërbimit pyjor.

7. Materiali drusor, i përpunuar ose i papërpunuar, si dhe prodhimet e tjera pyjore e jopyjore transportohen nga pikat e grumbullimit dhe qendrat e përpunimit deri në destinacionin përfundimtar, të shoqëruara me një vërtetim transporti, të lëshuar nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, nga bashkitë ose nga pronari privat, ku vërtetohet prodhimi i tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Modeli i vërtetimit të transportit miratohet nga ministri.

KREU VI/I
MONITORIMI DHE TË DHËNAT
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Neni 27/1
Monitorimi i pyjeve
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Monitorimi i pyjeve, që përfshin monitorimin e treguesve cilësorë dhe sasiorë të tyre, të biodiversitetit në pyje, të dukurive natyrore dhe të ndotjes e të dëmtimit të tyre, është proces i përhershëm dhe i detyrueshëm.

Neni 27/2
Programi i monitorimit
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Në bashkëpunim me organet qendrore dhe vendore, me Fakultetin e Shkencave Pyjore e me shoqatat e përdoruesve të pyjeve, ministria harton programin e monitorimit të pyjeve, si dhe bashkërendon e kontrollon punën për zbatimin e tij. Ministri miraton programin e monitorimit.

2. Programi i monitorimit të pyjeve përcakton treguesit e cilësisë së pyjeve, të biodiversitetit, të zhvillimit të ndotjes dhe dëmtimit, të dukurive natyrore, mënyrat e matjeve, të përpunimit të të dhënave, si dhe raportimin e botimin e tyre.

Neni 27/3

Sistemi i të dhënave

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Për të siguruar grumbullimin, përpunimin dhe botimin e të dhënave për pyjet, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese të pyjeve, me Policinë Pyjore, me qeverisjen vendore, me Fakultetin e Shkencave Pyjore e me shoqatat e përdoruesve të pyjeve, krijon sistemin e të dhënave, të domosdoshme për monitorimin e pyjeve.

2. Sistemi i të dhënave përmbledh tërësinë e treguesve shifrorë, të matshëm e të numërueshëm, që qartësojnë gjendjen e pyjeve dhe prirjet e proceseve që zhvillohen në to.

3. Në krijimin dhe përsosjen e sistemit të të dhënave, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve synon përafrimin e plotë të tij me sistemet që përdor FAO-ja dhe që përcaktohen në direktivat e BE-së.

Neni 27/4

Grumbullimi i të dhënave

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Të dhënat për monitorimin e pyjeve kërkohen, hartohen dhe paraqiten sipas rregullave të miratuara me udhëzim të ministrit. Personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, paraqesin të dhënat brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

2. Të dhënat shoqërohen me shpjegime për interpretimin e tyre, me rekomandime për zgjidhjen e problemeve që dalin dhe dorëzohen në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, në përputhje me formatin që ajo kërkon.

3. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve kontrollon cilësinë e monitorimit, të matjeve, zbatimin e metodikave, kualifikimin e specialistëve që marrin pjesë, pajisjet e përdorura dhe vërtetësinë e rezultateve.

Neni 27/5

Informimi dhe botimi i të dhënave

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve përpunon dhe dërgon për botim të dhënat dhe rezultatet që dalin prej tyre, në media dhe shtyp, në një formë të kuptueshme për publikun.

2. Në bazë të të dhënave dhe të rezultateve të monitorimit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me strukturat menaxhuese, harton dhe boton raportin vjetor për gjendjen e pyjeve. Përpunimi dhe botimi i të dhënave për vitin pararendës bëhen brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës.

3. Publiku dhe organizatat jofitimprurëse informohen për gjendjen e pyjeve, nëpërmjet botimit të të dhënave nga strukturat menaxhuese të pyjeve, nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, nga organet e qeverisjes vendore, si dhe duke kërkuar të dhëna pranë këtyre organeve.

4. Rregullat dhe procedurat për informimin e botimin dhe shpërndarjen e të dhënave janë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 27/6

Tërheqja në vendimmarrje

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Gjatë procesit të vendimmarrjes për pyjet, organet shtetërore, qendrore dhe vendore, sigurojnë pjesëmarrje dhe rol aktiv të komunitetit, të shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe të organizatave jofitimprurëse.

2. Ministri miraton rregullat e procedurat, që realizojnë pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjet e strukturave menaxhuese.

Neni 27/7
Shoqatat e përdoruesve të pyjeve
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Në procesin e zbatimit të këtij ligji, strukturat e menaxhimit të pyjeve dhe organet e qeverisjes vendore përfshijnë edhe shoqatat e përdoruesve të pyjeve.
2. Ministri përcakton rregullat dhe procedurat për përfshirjen e shoqatave, sidomos në hartimin, miratimin dhe zbatimin e:
a) strategjive, të planeve të veprimit dhe të programeve të zhvillimit të pyjeve;
b) planeve të mbarështimit e të programeve të monitorimit të pyjeve;
c) projektakteve normative për pyjet.
3. Përfaqësues të shoqatave të përdoruesve të pyjeve marrin pjesë në borde e komisione, që krijohen për administrimin dhe mbrojtjen e pyjeve, në nivel vendor dhe qendror.

Neni 27/8
Lidhjet me biznesin
(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Lidhjet me biznesin realizohen në rrugë institucionale, nëpërmjet dhomave të tregtisë dhe të industrisë, si dhe të organizatave profesionale të biznesit, të cilat paraqesin pikëpamjet e veta për hartimin dhe zbatimin e programeve të administrimit, të zhvillimit, të mbrojtjes e të shfrytëzimit të pyjeve.

KREU VII
BURIMET FINANCIARE DHE PËRDORIMI I TYRE

Neni 28
Funksionimi dhe përgjegjësitë financiare për pasurinë pyjore e kullosore

Shërbimi pyjor funksionon në përputhje me ligjin organik të Buxhetit të Shtetit dhe është përgjegjës për administrimin e pasurisë dhe të të ardhurave të realizuara nga veprimtaria ekonomike në sektorin e pyjeve e të kullotave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 29
Burimet financiare

Burimet financiare të shërbimit pyjor sigurohen nga:
a) Buxheti i Shtetit;
b) burime të brendshme;
c) donacione e grante të ndryshme.

Neni 30
Përdorimi i burimeve financiare

Burimet financiare të krijuara sipas nenit 32 përdoren për:
a) investime në sektorin e pyjeve dhe të kullotave;

b) mbrojtjen e faunës dhe të biodiversitetit të pyjeve dhe të kullotave;
c) parandalimin e sëmundjeve, të dëmtuesve dhe të zjarreve në pyje dhe kullota;
ç) kërkime shkencore në pyje dhe kullota;
d) krijimin e kushteve për kryerjen e veprimeve turistike dhe çlodhëse;
dh) shpërblimin e punonjësve për gjobat dhe sekuestrot e vendosura dhe të vjela sipas kritereve të caktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 31
Ndarja e burimeve financiare
(ndyshuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Burimet financiare, të krijuara sipas nenit 32, të ligjit, derdhen 100 për qind në buxhetin e bashkisë.

Neni 32
Bazueshmëria ligjore e burimeve fianciare

Sigurimi dhe përdorimi i të gjitha llojeve të burimeve financiare bëhen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 33
Të ardhurat e siguruara nga pyjet vendore
(shfuqizuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Neni 34
Tarifat në fondin pyjor publik
(ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Tarifat për të gjitha veprimtaritë, që zhvillohen në sektorin e pyjeve dhe të kullotave, për shërbimet publike e mjedisore, që zhvillohen në fondin pyjor publik, si dhe ato të vlerësimit të dëmeve në pyje miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave është struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

KREU VIII
KËRKIMI SHKENCOR NË FONDIN PYJOR KOMBËTAR

Neni 35
Veprimtaritë kërkimore e shkencore

1. Veprimtaritë kërkimore e shkencore në fondin pyjor kombëtar, për pyjet e tokat pyjore, kullotat, gërryerjet, pyllëzimet e përmirësimet, ripërtëritjen natyrore e problemet gjenetike, farërat e fidanët pyjorë, zjarret dhe luftimin e sëmundjeve e të dëmtuesve, florën e faunën e egër, bimët mjekësore e tanifere natyrore, përgatitjen dhe zbatimin e programeve të monitorimit për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve kryhen nga personat fizikë e juridikë, të cilët plotësojnë kërkesat dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarive kërkimore e shkencore.
2. Zhvillimi i veprimtarive kërkimore e shkencore, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet brenda fushave përkatëse të sektorit të pyjeve dhe të kullotave, në mbështetje të programeve kërkimore-shkencore kombëtare.

3. Institucionet kërkimore, studimore dhe shkencore në fushën e pyjeve e të kullotave sigurojnë konsulencë, oponencë dhe asistencë teknike për ministrinë përgjegjëse për pyjet, në aspekte të veçanta, brenda fushës së veprimtarisë së tyre.

4. Ministri përgjegjës për pyjet dhe ministri përgjegjës për shkencën harmonizojnë programimin dhe zbatimin e punës kërkimore në pyje e kullota, si dhe paraqesin kërkesat për buxhetin përkatës.

Neni 36

Bazat prodhuese dhe eksperimentale të zhvillimit dhe kualifikimit

1. Bazat prodhuese, eksperimentale, të ekstensionit, si për kërkimin shkencor dhe për kualifikimin e nxënësve e të studentëve, të punëtorëve, të specialistëve të pyjeve dhe të fushave të tjera në sektorin pyjor dhe për mjedisin në tërësi ngrihen me miratimin me shkrim të ministri përgjegjës për pyjet, në bazë të kërkesës së institucioneve kërkimore e pedagogjike.

2. Grumbujt e drurëve dhe të llojeve pyjore, të caktuara për konservim, germoplazmë, in situ dhe *ex situ*, për grumbullim, përpunim, shpërndarje dhe certifikim të materialit mbjellës, administrohen nga shërbimi pyjor.

KREU IX
PARASHIKIMET NDËSHKIMORE

Neni 37

Përgjegjësitë për moszbatimin e ligjit

(ndryshuar pika 2, dhe shtuar pika 4, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Shkeljet e dispozitave ligjore sjellin, sipas rastit, përgjegjësi administrative dhe penale.

2. Inspektorët e Policisë Pyjore, kur vërejnë shkeljen e këtyre dispozitave, mbajnë procesverbal, në përputhje me kërkesat e ligjit për inspektimin.

3. Të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 38 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Policisë Pyjore.

4. Punonjësit e tjerë të shërbimit pyjor, punonjësit e pushtetit vendor që mbulojnë pyjet dhe pronarët privatë, në rastet kur konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Policinë Pyjore për të kryer procedurat e nevojshme.

Neni 38

(ndryshuar me ligjin nr. 9791, datë 23.7.2007 ndryshuar pikat 1, 2 dhe 3, me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si me poshtë:

a) prerja pa leje e pyjeve, e pyjeve të reja, e filizërisë dhe e fidanishteve, si dhe dëmtimi i tyre e i tokës pyjore, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) prerja e drurëve pa damkën e organeve të shërbimit pyjor, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

c) përdorimi i paligjshëm i fondit dhe i tokës pyjore dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ç) prerja pa leje apo dëmtimi i pyjeve, në pronësi private, nga pronarët apo nga subjektet, të cilave u janë dhënë në përdorim ose me qira, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 40 000 (dyzet mijë) lekë;

d) kullotja e bagëtive në pyjet e reja, në pyllëzime, në filizëri e fidanishte, në parcelat gjenetike e eksperimentale e në pyjet mbrojtëse, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

dh) grumbullimi i prodhimeve pyjore e jopyjore, si rrëshirë, boçe, hala, gjethe, bar, lëgushë, humus, plisa, rrënjë e lëvore, lule, fruta, sytha e herbë, kërpudha, bimë mjekësore, eterovajore, tanifere, patavra, cungje, kucka, fashina, thupra, hunj, bandiera, zhuka e kallamishte, gurë, zhavorr e rërë, pa lejen përkatëse të organit të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 5 000 (pesë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

e) nxjerrja e rrënjëve të shqopës, bushit, maresë dhe prerja e thuprës së shelgut e të llojeve të tjera të drurëve pyjorë, gjatë periudhës së vegjetacionit, dënohen me gjobë 20 000 (njëzet mijë) deri në 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë;

ë) krasitja për gjethe dhe kositja e grumbullimi i barit në fondin pyjor, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 8 000 (tetë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

f) mbledhja e prodhimeve të dyta pyjore e jopyjore e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere, e bimëve të rralla e të kërcënuara e të tjera të kësaj natyre, jashtë periudhës teknike të vjeljes e me mënyra që sjellin degradimin, kërcënimin, rrallimin, zhdukjen apo dobësimin e funksioneve të tyre, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

g) ndërhyrjet me punime të ndryshme në ligatinat dhe dunat bregdetare, pjesë përbërëse të fondit pyjor kombëtar, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

gj) ndezja e zjarreve jashtë vendeve të caktuara nga organet e shërbimit pyjor dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

h) prishja apo përdorimi i çekiç-damkës e i damkës nga persona të paautorizuar dhe nga një zonë pyjore në tjetrën, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

i) prishja, fshirja ose dëmtimi i shenjave kufidëftuese, gjeodezike e topografike, i tabelave paralajmëruese apo treguese, të vendosura në fondin pyjor kombëtar, dënohen me gjobë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë;

j) ndërtimi i furrave të gëlqeres dhe i kaminave të qymyrit të drurit në fondin pyjor, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

k) ngritja e ndërtimeve të thjeshta, gardhimeve, kampingjeve, brenda territoreve të gardhuara të fondit pyjor dhe të atyre të deklaruara me funksion mbrojtës e të veçantë, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, dënohet me gjobë 20 000 (njëzet mijë) deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

l) hedhja e mbetjeve urbane dhe e inerteve brenda në pyll ose në tokën pyjore dhe jashtë vendeve të caktuara, kur pasojat materiale janë të lehta, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ll) parkimi i automjeteve, vendosja e rulotave në pyjet me funksion mbrojtës e të veçantë, në parqet kombëtare, në rezervatet e mbarështimit të florës e të faunës së egër, në fidanishtet pyjore ose në vendet e tjera të fondit pyjor, me rëndësi të veçantë, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohen me gjobë 3 000 (tre mijë) deri në 5 000 (pesë mijë) lekë;

m) ndryshimi i zërit kadastral apo i kulturave pyjore nga pronari privat, pa miratimin e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 7 000 (shtatë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

n) mosraportimi nga pronari i ndryshimeve përkatëse në fondin pyjor dhe në tokën pyjore, brenda 6 muajve nga data e vënies re, dënohet me gjobë 3 000 (tre mijë) deri në 5 000 (pesë mijë) lekë;

nj) transferimi i të drejtave, të siguruara nga leja e ushtrimit të veprimtarisë në fondin pyjor kombëtar, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

o) transporti me kamionë i materialit drusor nga pylli dhe prej shesheve të depozitimit për në qendrat e përpunimit e të shitjes, i pashoqëruar me lejen tip të transportit, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

p) mosruajtja e materialit drusor dhe e çdo prodhimi tjetër, me origjinë pyjore, të sekuestruar, i cili ndodhet në qendrat e përpunimit apo në sheshet e depozitimit e të tregtimit, nga subjektet, të cilave u është sekuestruar, deri në shitjen e tyre, dënohet me gjobë 8 000 (tetë mijë) deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë;

q) tregtimi ose tjetërsimi i materialeve drusore dhe i prodhimeve të tjera, pyjore e jopyjore të fondit pyjor kombëtar, pa lejen e organeve të shërbimit pyjor, dënohet me gjobë 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

r) tregtimi i materialit drusor dhe i prodhimeve të tjera të pyllit, të infektuara nga sëmundjet, barërat e këqija e parazitare ose të prekura nga insektet, dënohet me gjobë 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

rr) mosnjoftimi i inspektoratit për shkeljet e konstatuara nga subjektet e përcaktuara në pikën 4 të nenit 37 përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me 10 000 (dhjetë mijë) lekë gjobë.

2. Kur shkeljet e këtij ligji kanë sjellë pasoja të rënda, Policia Pyjore bën kallëzim penal. Kriteret për ndarjen e shkeljeve me pasoja të lehta apo me pasoja të rënda caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Sipas nevojave të rastit, krahas dënimit kryesor me gjobë, merren edhe masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 39

Sekuestrimet

Mjetet dhe gjithçka tjetër, që shërben për kryerjen e kundërvajtjes administrative dhe çdo përfitim pasuror, i vënë nëpërmjet kundërvajtjes administrative, sekuestrohen dhe kalojnë në llogari të organeve të shërbimit pyjor.

Neni 40

Vendimi për kundërvajtjet administrative dhe ankimi

(ndryshuar pika 3, me ligjin nr.9533, datë 15.5.2006, ndryshuar me ligjin nr. 36/2013, datë 14.2.2013 dhe nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative merret nga Policia Pyjore, në zbatim të legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndaj vendimit të dhënë, në zbatim të pikës 1, të këtij neni, bëhet ankim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Procedura e ekzekutimit të vendimit të dënimit me gjobë bëhet në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 40/1

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007 dhe nr. 36/2013, datë 14.2.2013)

1. Për çdo rast të kryerjes së kundërvajtjes administrative apo veprës penale në pyje, nga inspektori vlerësohet edhe dëmi që është shkaktuar.

2. Struktura menaxhuese e sipërfaqeve pyjore, pronë shtetërore, ose bashkia përkatëse që ka në pronësi sipërfaqen pyjore, në të cilën ka ndodhur kundërvajtja, janë të detyruara të kërkojnë, në çdo rast, shpërblimin e dëmit nga kundërvajtësi. Këtë të drejtë e gëzon edhe pronari privat për sipërfaqen në pronësi të tij.

3. Në zbatim të këtij neni, Policia Pyjore njofton subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni për dënimin e konstatuar dhe u përcjell atyre të gjithë praktikën përkatëse.

4. Kriteret dhe mënyra e caktimit të vlerës së dënimit të shkaktuar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 40/2

Likuidimi i gjobës

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 48/2016, datë 5.5.2016)

Neni 40/3

Lidhja e kontratës

(shtuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

Personat juridikë e fizikë, që kanë bërë instalime, ndërtime dhe ushtrojnë veprimtari në fondin pyjor publik, pa lidhur kontrata me drejtorinë përkatëse të shërbimit pyjor, duhet t'i lidhin ato brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Pas këtij afati, Policia Pyjore bën mbylljen e përhershme të veprimtarive dhe çmontimin e instalimeve.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 41

Shfuqizimi i dispozitave ligjore

Ligji nr.7623, datë 13.10.1992 "Për pyjet dhe Policinë Pyjore", i ndryshuar, ligji nr.8302, datë 12.3.1998 "Për administrimin e të ardhurave që krijohen në pyje dhe kullota - pasuri shtetërore" dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 42

Aktet nënligjore

(ndryshuar me ligjin nr.9791, datë 23.7.2007)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7 pika 4, 9 pika 3, 17 pika 1 shkronja "b" e pika 2, 19 pika 2, 20 pika 9, 21 pika 8, 23 pika 7, 26 pikat 2, 8 e 10, 27 pika 5, 38 pika 2 dhe 40/1 pika 2.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë urdhrat dhe udhëzimet në zbatim të neneve 5 pika 6, 8 pika 2, 16 pikat 5 e 8, 17 pika 1 shkronja "a", 19 pika 3, 20 pika 12, 25 pika 2, 26 pika 11, 27 pika 7, 27/2 pika 1, 27/4 pika 1, 27/5 pika 4, 27/6 pika 2 dhe 27/7 pika 2.

DISPOZITË KALIMTARE E LIGJIT NR. 36/2013, DATË 14.2.2013

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

DISPOZITË KALIMTARE E LIGJIT NR. 48/2016, DATË 5.5.2016

Dispozitë kalimtare

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për pyjet, brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton transferimin e pyjeve në pronësi të bashkive.

Neni 43
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4591, datë 1.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ[29]
Nr.10 440, datë 7.7. 2011

PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS[30]

(Ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësive, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike.

---

*[29] * Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivën 85/337/KEE të Këshillit, datë 27 qershor 1985 "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin", të ndryshuar, numri CELEX: 31985L0337, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 175, datë 5.7.1985, faqe 40-48.*

[30] Ligji nr.10 440, datë 7.7. 2011 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 1 gusht 2011.
Ligji nr. 12/2015, datë 26.2.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 38, datë 18 mars 2015.